

Clark: Dhamë dëshmi që do ta rrëzojnë këtë dënim, ShBA të punojë që Apeli ta marrë vendimin e duhur



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

TROMP: SPECIALJA U KRIJUA PËR TA KËNAQUR SERBINË, JO PËR DREJTËSI



Procesi i apelit mund të sjellë ndryshime në dënimet që Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë i shqiptuan më 16 shtator kundër katër ish-udhëheqësve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) të cilët i shpallën fajtorë për krime lufte, thotë Nevenka Tromp, hulumtuuese e

Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë. Por, Tromp, e cila ka ndjekur nga afër edhe procesin ndaj Hashim Thaçit, Jakup Krasniqit, Kadri Veselit dhe Rexhep Selimit në atë që njihet edhe si Gjykata Speciale e Kosovës, thotë se më i mundshëm është një

ndryshim i pjesshëm sesa i plotë i aktgjykimit ndaj tyre. Tromp e cilësoi si "mëkat fillestar" të Dhomave të Specializuara faktin që, sipas saj, ato u konceptuan për ta "kënaqur" Serbinë, dhe jo si një institucion i mirëfilltë i përcaktimit të përgjegjësisë

HAMZA: VENDIMI I SPECIALES DËMTON HISTORINË, TË TASHMEN DHETË ARDHMEN E KOSOVËS. DUHET TË TAKOHEMI ME TË GJITHË LIDERËT POLITIKË F. 5



KUVENDI I SHQIPËRISË DEL ME DEKLARATË TË PËRBASHKËT PËR UÇK-NË: NUK MUND TË BARAZOHET AGRESORI ME VIKTIMËN F. 5



KONGRESI AMERIKAN E MIRATON LIGJIN PËR SANKSIONE GJITHËPËRFSHIRËSE NDAJ RUSISË F. 2

MARK CARNEY PRANON PROPOZIMIN QË KANADAJA TË BËHET ANËTARE E ASOCIUAR E BE-së F. 2

STUDENTËT KËRKOJNË DREJTËSI PËR ISH-KRERËT E UÇK-së: JO NË EMËR TË STUDENTËVË F. 3

"PRISHTINA 2026" PROMOVON PRODUKTET VENDORE DHE HAP MUNDËSI TË REJA PËR BIZNESET F. 8

RRITET BRUTO PRODUKTIN VENDOR, NDËRTIMTARIA DHE SEKTORI FINANCIAR SHËNOJNË RRIJTJEN MË TË LARTË F. 8

SPORT



DELLOVA DHE KRASNIQI GRUMBULLOHEN ME KOSOVËN F. 10

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

KONGRESI AMERIKAN E MIRATON LIGJIN PËR SANKSIONE GJITHËPËRFSHIRËSE NDAJ RUSISË

WASHINGTON, 17 SHTATOR - Kongresi i Shteteve të Bashkuara e miratoi të mërkurën një ligj me sanksione gjithëpërfshirëse që shënjestrojnë Rusinë dhe Iranin, dhe ia ka dërguar presidentit Donald Trump për ta nënshkruar.

Paketa e sanksioneve, sipas mbështetësve të saj, do ta rrisë tryshninë ndaj Moskës dhe vendeve që ndihmojnë në financimin e luftës së saj kundër Ukrainës.

Dhoma e Përfaqësuesve miratoi Ligjin Lindsey O. Graham për Sanksionimin e Rusisë dhe Iranit, me 262 vota për dhe 159 kundër. Për votuan 203 republikanë, 58 demokratë dhe një ligjvënës i pavarur. Kundër votuan shtatë republikanë dhe 152 demokratë.

Projektligji kishte kaluar tashmë Senatit me 86 vota për dhe 11 kundër muajin e kaluar.

Ai mban emrin e senatorit të ndjerë republikan Lindsey Graham nga Karolina e Jugut, i cili kaloi më shumë se një vit duke ndërtuar mbështetje dypartiake për këtë legjislacion, para se të vdiste papritur në korrik.

Tani Trumpi pritet ta nënshkruajë atë.

Legjislacioni synon zyrtarët rusë, institucionet financiare, sektorin energjetik dhe të ashtuquajturën flotë në hije të vendit, e përbërë nga cisterna. Ai gjithashtu i jep Trumpit autoritetin të vendosë tarifa deri në 100 për qind ndaj blerësve të mëdhenj të naftës dhe gazit rus, si dhe ndaj vendeve që ndihmojnë Moskën t'u shmanget sanksioneve.

Ligji gjithashtu zgjat sanksionet amerikane ndaj Iranit.

Ky është legjislacioni i parë i madh dypartiak i Kongresit në mbështetje të Ukrainës që nga paketa e ndihmës emergjente e miratuar në prill 2024.



Mospajtimet mes demokratëve për tarifat

Rruga e projektligjit në Dhomën e Përfaqësuesve u ndërlikua nga kundërshtimi i demokratëve, i përqendruar kryesisht te kompetencat shtesë për vendosjen e tarifave që i jepen Trumpit.

Udhëheqësi i pakicës në Dhomën e Përfaqësuesve, Hakeem Jeffries nga Nju-Jorku, tha se mbështet ushtrimin e tryshnisë ndaj Rusisë, por nuk mund të mbështeste atë që e përshkroi si kompetenca të gjerë të reja tarifore për presidentin.

Përfaqësuesi Gregory Meeks nga Nju-Jorku, demokrati më i lartë në Komitetin e Dhomës së Përfaqësuesve për Punët e Jashtme, tha gjithashtu se mbetet i përkushtuar për ndalimin e luftës së Rusisë kundër Ukrainës, por kundërshton dispozitat e projektligjit për tarifat.

Meeks tha se Trumpi tashmë ka kompetenca të konsiderueshme për të vendosur sanksione ndaj Moskës dhe argumentoi se projektligji duhej të kishte përfshirë kërkesa më të forta për

administratën që t'i përdorte ato kompetenca.

Megjithatë, 58 demokratë votuan për legjislacionin, duke pasqyruar mbështetjen e vazhdueshme të shumë ligjvënësve për vendosjen e kostove shtesë ekonomike ndaj Rusisë.

Kritikët ngritën gjithashtu shqetësime se kompetencat për vendosjen e tarifave mund të prekin partnerët dhe aleatët e ShBA-së, përfshirë vendet evropiane që vazhdojnë të importojnë energji ruse.

Por, zyrtarët evropianë të cituar pas votimit nuk e përsëritën argumentin më të gjerë se Evropa e kundërshtonte legjislacionin.

Hannes Hanso, ambasadori i Estonisë në Shtetet e Bashkuara, i tha REL-it më 16 shtator se Tallini mbështet sanksione të forta ndaj Rusisë dhe dëshiron që ato të zbatohen shpejt. "Ne mbështesim sanksione sa më të forta ndaj Rusisë", tha Hanso. "Ata janë agresori, kështu që kjo tani mundëson sanksione shumë të fuqishme, të forta dhe gjithëpërfshirëse".

Hanso pranoi se legjislacioni nuk ishte i përsosur, por tha se

përparësi ishte vënia në zbatim e sanksioneve të reja. "Sa më shpejt t'i zbatojmë këto sanksione ndaj Rusisë, aq më mirë", tha ai.

BE-ja ka mbajtur sanksione të gjera ndaj Rusisë, ndërsa qeveritë evropiane kanë vazhduar të bëjnë thirrje për presion ndaj Moskës për shkak të luftës së saj kundër Ukrainës.

Për përfaqësuesen Marcy Kaptur nga Ohajo, bashkëkryetare e Grupit të Kongresit për Ukrainën, fokusi tani zhvendoset nga veprimi i Kongresit te mënyra se si administrata Trump do t'i përdorë kompetencat e reja. "Ne do t'i kushtojmë vëmendje të madhe administratës dhe do të shohim se çfarë do të bëjnë me këto kompetenca të reja që u janë dhënë", i tha Kaptur REL-it.

Mbështetësit e legjislacionit thonë se dispozitat për tarifat synojnë vendet, të cilat e ndihmojnë Moskën ta financojë luftën duke blerë energji ruse. Senatori Richard Blumenthal nga Konektikati, bashkautor demokrat i legjislacionit, i dërgoi një mesazh të drejtpërdrejtë Kremlinit pas votimit. "Vladimir Putin, ne e

dimë numrin tuaj", tha Blumenthal.

Ai paralajmëroi Kinën dhe Indinë se blerjet e vazhdueshme të naftës dhe gazit rus mund t'i ekspozojnë ato ndaj masave të reja amerikane. "Kinë dhe Indi, më mirë përmirësojeni sjelljen tuaj, blini naftë dhe gaz diku tjetër", tha ai.

Blumenthal tha se legjislacioni synon të rrisë presionin ndaj Moskës dhe ta detyrojë Putinin të hyjë në negociata, ndërsa theksoi se vetëm sanksionet nuk do të jenë të mjaftueshme. "Qetësimi i agresorit nuk është strategji", tha ai, duke shtuar se Kongresi do të duhet të vazhdojë t'i ofrojë Ukrainës mbështetje ushtarake, ekonomike dhe politike.

Senatorja Jeanne Shaheen nga Nju-Hempshajri, demokratja më e lartë në Komitetin e Senatit për Marrëdhëniet me Jashtë, tha se masa i dërgon Putinit një "mesazh të pamohueshëm, dypartiak". "Çdo dollar që Rusia fiton përmes shitjeve të paligjshme të energjisë është një dollar tjetër që Putini mund ta përdorë për të blerë dronë, raketa dhe armë për të vrarë ukrainas të pafajshëm", tha Shaheen.

Ajo i bëri thirrje Trumpit ta nënshkruajë projektligjin dhe t'i përdorë kompetencat e reja për t'i bërë presion Putinit që të negociojë "në mënyrë kuptimplotë" për t'i dhënë fund luftës.

Senatorja republikane Katie Britt nga Alabama, një mbështetëse e rëndësishme e legjislacionit, tha se masa do ta mbajë gjithashtu Iranin përgjegjës për atë që ajo e përshkroi si "47 vjet terror".

Projektligji e zgjat për pesë vjet Aktin për Sanksionet ndaj Iranit, duke ruajtur sanksionet që synojnë sektorët energjetikë dhe të armëve të Iranit.

MARK CARNEY PRANON PROPOZIMIN QË KANADAJA TË BËHET ANËTARE E ASOCIUAR E BE-së

OTAVA, 17 SHTATOR - Kryeministri i Kanadasë, Mark Carney, iu drejtua të enjten Parlamentit Evropian, ku deklaroi se Kanadaja dhe Bashkimi Evropian duhet ta thellojnë bashkëpunimin përballë sfidave të reja gjeopolitike, ekonomike dhe të sigurisë.

Carney tha se Kanadaja dhe BE-ja ndajnë vlera të përbashkëta, përfshirë sundimin e ligjit, demokracinë, dinjitetin njerëzor dhe liritë individuale. Sipas tij, të dyja palët duhet ta forcojnë sovranitetin e tyre përmes bashkëpunimit në fusha strategjike.

Duke iu referuar propozimit të presidentes së Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, që Kanadaja të bëhet anëtarja e parë "e asociuar" e BE-së, Carney tha se Ottawa e mirëpret këtë ambicie dhe është e gatshme ta zhvillojë së bashku me Evropën, shkruan "euronews". Ai përmendi mineralet kritike, energjinë, teknologjinë dhe sigurinë ekonomike si fusha ku bashkëpunimi mund të zgjerohet. Sipas tij, Kanadaja mund të kontribuojë në sigurinë energjetike të Evropës përmes furnizimit me LNG dhe hidrogjen, ndërsa mund të

përfitojë nga teknologjitë evropiane të energjisë së pastër. Carney propozoi gjithashtu forcimin e lidhjeve mes qytetarëve, veçanërisht të rinjve, përmes mundësive për të studiuar, punuar dhe jetuar në të dyja anët e Atlantikut. Ai përmendi pjesëmarrjen e Kanadasë në programin Erasmus+ si një mundësi për zgjerimin e këtyre lidhjeve. "Evropa dhe Kanadaja së bashku janë edhe më të forta", tha Carney, duke theksuar se partneriteti nuk synon krijimin e një blloku rival, por forcimin e qëndrueshmërisë dhe sovranitetit të të dyja palëve.



HAMZA: VENDIMI I SPECIALES DËMTON HISTORINË, TË TASHMEN DHE TË ARDHMEN E KOSOVËS. DUHET TË TAKOHEMI ME TË GJITHË LIDERËT POLITIKË

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 17 SHTATOR - Reagimet ndaj vendimit dënues të Gjykatës Speciale për ish-krerët e UÇK-së kanë vazhduar edhe të enjten në Prishtinë.

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Bedri Hamza, ka folur pas takimit të Kryesisë dhe grupit parlamentar të kësaj partie të enjten, ku është diskutuar situata pas vendimit të djeshëm të Gjykatës Speciale në Hagë ndaj ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Hamza tha se në PDK ekziston një qëndrim i përbashkët se vendimi është i padrejtë, i paqëndrueshëm dhe, sipas tij, i pabazuar në fakte. “Është një konstatim i përgjithshëm se vendimi është i padrejtë, është i paqëndrueshëm, i pabazuar në fakte. Është një vendim i cili e dëmton historinë, të tashmen dhe të ardhmen e Kosovës”, tha Hamza.

Ai deklaroi se PDK-ja do të angazhohet për komunikim me subjektet e tjera politike, duke theksuar se çështja nuk duhet të trajtohet vetëm si çështje e një partie politike. “Unë besoj se do të takohemi me të gjithë liderët e subjekteve politike, sepse kjo nuk është më çështje që i takon një subjekti politik”, u shpreh Hamza. Sipas tij, PDK-ja synon krijimin e një konsensusi ndërmjet subjekteve politike dhe paralajmëron veprime përmes rrugëve ligjore dhe demokratike.

Hamza tha gjithashtu se e njeh të drejtën e qytetarëve për të protestuar dhe për ta shprehur mospajtimin e tyre, por kërkoi që çdo veprim të zhvillohet në përputhje me rregullat demokratike dhe pa dëmtuar institucione apo persona. “Besoj në bashkëpunimin me subjektet e tjera politike, në krijimin e një konsensusi të nevojshëm dhe ne si Parti Demokratike e Kosovës do të dalim me veprime konkrete, duke përfshirë edhe ato ligjore dhe demokratike”, tha ai.

Për dënimet e ish-krerëve të UÇK-së ka reaguar edhe Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS). GLPS-ja ka theksuar se shpallja e aktgjykimit në rastin ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit përbën një nga momentet më të rënda dhe më të ndjeshme për shoqërinë tonë. “Për një popull që ende jeton me dhimbjen e luftës, që vazhdon të kërkojë drejtësi për viktimat dhe të zhdukurit dhe që e ka përjetuar luftën si një përpjekje për çlirim nga një regjim agresor dhe shtypës, ky aktgjykim nuk mund të trajtohet si një vendim i zakonshëm gjyqësor. Ai prek drejtpërdrejtë kujtesën

kolektive, dinjitetin e viktimave dhe shtetin tonë”, thuhet në reagim.

GLPS-ja shpreh zhgënjimin e thellë ndaj aktgjykimit dhe dënimeve të shqiptuara ndaj katër ish-udhëheqësve të UÇK-së dhe konsideron se përfundimet e këtij aktgjykimi duhet të shqyrtohen me rigorozitet të plotë, paanshmëri dhe drejtësi në shkallën e ankimimit. “Në këtë drejtim, presim që Dhoma e Apelit të luajë rolin e saj në mënyrë të pavarur, profesionale dhe të paanshme dhe të jetë në gjendje të shqyrtojë në mënyrë të pavarur dhe në kohë të arsyeshme nëse përfundimet e shkallës së parë janë të mbështetura në ligj dhe në prova, pa qenë e lidhur nga përfundimet e saj. Është e papranueshme që pesha e akuzave të tilla të vazhdojë të rëndojë mbi individët dhe kujtesën e një shoqërie. Pozita politike apo ushtarake nuk mundet që me automatizëm të cilësojë si fajtor askënd nëse nuk provohet lidhja kauzale shkak-pasojë me prova bindëse, justifikim të plotë dhe të ligjshëm të zhvilluar në një proces gjyqësor të drejtë dhe të paanshëm”, theksohet në reagimin e GLPS-së.

Sipas GLPS-së, ky aktgjykim duhet të vlerësohet në kontekstin e plotë të luftës në Kosovë dhe të praktikës së drejtësisë ndërkombëtare për krimet e kryera ndaj popullsisë civile. “E drejta ndërkombëtare nuk mund të funksionojë mbi standarde të dyfishta. Në këtë aspekt, është thelbësore të merret parasysh mënyra se si drejtësia ndërkombëtare ka trajtuar rastet e zyrtarëve të lartë politikë, ushtarakë dhe policorë të aparatit shtetëror serb të gjykuar për krimet shtetërore të kryera me planifikim në Kosovë. Ky disproporcion kërkon shqyrtim serioz dhe nuk mund të relativizohet apo të lihet jashtë debatit mbi drejtësinë për luftën në Kosovë.

Drejtësia ndërkombëtare duhet të jetë e barabartë në standarde, por jo e verbër ndaj kontekstit,



raportit të forcave dhe pozitës së viktimës dhe agresorit, e që këto pozicione janë të njohura botërisht. Çdo përpjekje për ta trajtuar këtë luftë sikur palët kanë pasur të njëjtën pozitë historike, politike dhe juridike është një minim i realitetit të luftës në Kosovë dhe i raportit thellësisht të pabarabartë në të cilin palët kanë hyrë dhe kanë vepruar gjatë saj”, thuhet në reagim, duke shtuar se ky aktgjykim vjen pas një procesi penal jashtëzakonisht të gjatë, i cili ka zgjatur me vite dhe ka pasur pasoja të rënda për ish-krerët e UÇK-së, e që në praktikë ka cenuar një nga parimet themelore të drejtësisë që është gjykimi në kohë të arsyeshme. “Gjatë këtij procesi janë ngritur çështje që lidhen me barazinë e armëve, drejtësinë në administrimin e provave, pavarësinë dhe zbatimin praktik të standardeve të të drejtave të njeriut. Në këtë drejtim, përmbledhja e aktgjykimit nuk i adreson aspektet thelbësore të identifikuar në raportin e Bar Human Rights Committee of England and Wales (BHRC), sa i përket të drejtave të njeriut. Ndër të tjera, mënyra se si duket që janë trajtuar dhe vlerësuar provat në këtë proces krijon shqetësime serioze se standardi i provës përtej dyshimit të arsyeshëm është cenuar në mënyrë serioze. Këto çështje nuk mund të anashkalohen në vlerësimin e këtij aktgjykimi

Studentët kërkojnë drejtësi për ish-krerët e UÇK-së: Jo në emër të studentëve

Një grup studentësh kanë protestuar të enjten në Prishtinë, duke mbajtur flamuj dhe pankarta në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së. “Jo në emër të studentëve”, “Justice for KLA is justice for Kosovo”, “Nuk ka gjyq që ju gjykon në emër të popullit. Të pafajshëm përgjithmonë!” ishin disa nga thirrjet e studentëve.

Ilir Cani, përfaqësues i studentëve, tha se vendimi është ndikuar politikisht dhe nuk ka të bëjë me drejtësinë. Ai theksoi se Serbia ishte agresorja gjatë luftës në Kosovë dhe tha se protestat e sotme janë paqësore, ndërsa paralajmëroi protesta më të mëdha nëse nuk ka ndryshim. “Liri çlirimtarëve, rroftë UÇK-ja, rroftë kombi shqiptar. Ai vendim është marrë me influencë politike, nuk kishte të bënte me drejtësinë. Serbia ishte agresori dhe kriminel i vërtetë, jo UÇK-ja”, tha ai.

OVLUÇK-ja të premten protestë

Organizata e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ka paralajmëruar protestë gjithëpopullore për të premten, më 17 shtator, në orën 12:00 në sheshin “Skënderbeu” në Prishtinë, pas zhvillimeve të fundit në procesin gjyqësor ndaj drejtuesve të UÇK-së. “Organizatat e dala nga lufta sot në takimin që mbajtëm me këshillin drejtues, morëm vendim që të thërrasim protestë gjithëpopullore nesër në ora 12:00 në sheshin “Skënderbeu”, tha nënkryetari i OVLUÇK-së, Gazmend Sylja.

Ai tha se zhvillimet e fundit, sipas tij, kanë tentuar ta vendosin në një balancë luftën e UÇK-së me atë që ka ndodhur gjatë viteve 1998-1999. “Dje dhe sot u ul lufta jonë për çlirim dhe u provua të bëhet një balancë mes asaj që ka ndodhur në luftën tonë në vitet ‘98-’99. UÇK-ja nuk është kurrë ndërmarrje kriminale, kjo ishte rezistenca në kuptimin tonë përballë dëbimit, masakrave dhe e vetmja përgjigje e një kombi që ishte dënuar me zhdukje. Asnjë vendim nuk mund ta njollojë luftën tonë çlirimtare apo të barazojë ata që luftuan për liri. Që nga fillimi e kemi quajtur këtë gjykatë politike dhe procesin të padrejtë, gjë që sipas nesh u dëshmuua edhe dje”, deklaroi Sylja.

Ai bëri me dije se organizatat e dala nga lufta synojnë të ndërmarrin hapa të tjerë, përfshirë krijimin e një këshilli koordinues kombëtar dhe një platforme që do t'i përfshinte edhe shqiptarët jashtë Kosovës.





TROMP: SPECIALJA U KRIJUA PËR TA KËNAQUR SERBINË, JO PËR DREJTËSI

Prishtinë, 17 shtator - Procesi i apelit mund të sjellë ndryshime në dënimet që Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë i shqiptuan më 16 shtator kundër katër ish-udhëheqësve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), të cilët i shpallën fajtorë për krime lufte, thotë Nevenka Tromp, hulumtuese e Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë.

Por, Tromp, e cila ka ndjekur nga afër edhe procesin ndaj Hashim Thaçit, Jakup Krasniqit, Kadri Veselit dhe Rexhep Selimit në atë që njihet edhe si Gjykata Speciale e Kosovës, thotë në një intervistë për Radion Evropa e Lirë (REL) se më i mundshëm është një ndryshim i pjesshëm sesa i plotë i aktgjykimit ndaj tyre.

Para intervistës, në disa komente për REL-in, Tromp e cilësoi si “mëkat fillestar” të Dhomave të Specializuara faktin që, sipas saj, ato u konceptuan për ta “kënaqur” Serbinë, dhe jo si një institucion i mirëfilltë i përcaktimit të përgjegjësisë. Ajo vlerësoi se gjykata u krijua më 2015 si çmim për vazhdimin e mbështetjes perëndimore për Kosovën, “me pritjen se lëshimet ndaj Beogradit do të çonin drejt njohjes së pavarësisë” së shtetit. Sipas Trompit, aktgjykimi kundër katër ish-krerëve të UÇK-së ka pasoja përtej përgjegjësisë së tyre individuale. Ajo veçon konstatimin për “ndërmarrjen e përbashkët kriminale” dhe përmendjen në aktgjykim të

personave që nuk ishin të pandehur në këtë çështje.

Mbrojtja e katër të dënuarve ka paralajmëruar apel. Bazuar në aktgjykimin e 16 shtatorit, ku i shihni bazat më të forta juridike për ta kundërshtuar shpalljen e fajësisë?

Nevenka Tromp: Kryesorja është kundërshtimi i vetë ekzistencës së “qëllimit të përbashkët kriminal”, së bashku me mënyrën se si aktgjykimi e dalloi kontributin individual të katër të pandehurve. U konstatua se Thaçi dhe Krasniqi i kishin përdorur aktivisht pozitat e tyre për t’i zbatuar aspektet kriminale të “qëllimit të përbashkët”, ndërsa shpallja fajtor e Selimit mbështetet në një cilësim thelbësisht të ndryshëm: mosparandalimin dhe mosndëshkimin e krimeve për të cilat ai kishte autoritetin dhe dijeninë për të vepruar, një konstatim i bazuar në mosveprim dhe jo në zbatim aktiv.

Kjo është baza më e kundërshtueshme në apel, sepse varet nga vlerësime të lidhura me faktet specifike rreth asaj që ai dinte, kur dinte dhe çfarë mund të bënte realisht lidhur me të. Një bazë e dytë e mundshme ka të bëjë me vetë materialin provues, veçanërisht me mbështetjen në deklaratat e dëshmitarëve, të marra shumë vite pas ngjarjeve në fjalë, të cilat ekipet e mbrojtjes pranë Dhomave të Specializuara i kanë kundërshtuar në procedura të mëparshme.

Sa e vështirë është, nga pikëpamja e së drejtës së apelit, të kundërshtohet konstatimi i trupit gjykues se të katër të dënuarit kishin dhe zbatonin një qëllim të përbashkët kriminal?

Nevenka Tromp: Është e vështirë. Shqyrtimi në apel në këtë sistem, i trashëguar nga jurisprudenca e Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (TPNJ), nuk i peshon sërish provat; ai përqendrohet në zbatimin e ligjit mbi provat dhe faktet, ashtu siç janë konstatuar. Gjyqtarët e ndërtuan konstatimin për “qëllimin e përbashkët” në mënyrë kumulative - nga modelet e shënjestrimit të “bashkëpunëtorëve” të supozuar para dhe gjatë luftës, nga komunikatat dhe deklaratat politike që u referoheshin “masave ndëshkuese”, si dhe nga struktura dhe mënyra e veprimit të objekteve të ndalimit në të gjithë territorin e kontrolluar nga UÇK-ja. Pritja realiste është një apel që e ngushton aktgjykimin në aspektet e tij anësore: cili individ lidhej me cilat krime specifike, nëse viktimat të caktuara i ishin atribuar siç duhej “qëllimit të përbashkët”.

Cilat rezultate janë ligjërisht të mundshme në apel? A mund të rrëzohet shpallja e fajësisë, të ndryshohen konstatime të veçanta ose të ulen dënimet?

Nevenka Tromp: Paneli i Gjykatës së Apelit i Dhomave të Specializuara mund ta konfirmojë

aktgjykimin, ta rrëzojë shpalljen e fajësisë për pika të caktuara të aktakuzës, t’i rrisë ose t’i ulë dënimet, ose, në parim, të urdhërojë një rigjykim të pjesshëm për çështje të veçanta. Një shkallë tjetër, Paneli i Gjykatës Supreme, është i disponueshëm në rrethana më të kufizuara, përfshirë rastet kur në apel shpallet fajësi pas një shpalljeje të pafajësisë, ose gjatë shqyrtimit të dënimeve veçanërisht të rënda. Duke pasur parasysh dallimet tashmë të dukshme në aktgjykimin e shkallës së parë, rezultati më i mundshëm nuk është një rrëzim i plotë, por një i pjesshëm - një ulje, veçanërisht për Selimin ose Veselin, kontributin e të cilëve në “qëllimin e përbashkët”, gjyqtarët e Dhomave të Specializuara e cilësuan me terma më të dobët sesa atë të Thaçit dhe Krasniqit. Por, aktgjykimet në apel në gjykatat penale ndërkombëtare mbeten të paparashikueshme. Vlen gjithashtu të kujtohet se vetë Tribunali në Hagë pati raste, në të cilat dënime të rënda të trupit gjykues u rrëzuan në apel, deri në shpallje pafajësie. Gjithçka mbetet e mundshme.

E, çfarë nëse Prokuroria vendos të apelojë? Kjo meriton të merret seriozisht, sepse një apel i Prokurorisë do të shënjestronte pjesën e aktgjykimit që aktualisht i jep mbrojtjes dhe Qeverisë së Kosovës bazën e tyre më të fortë retorike: shpalljen e pafajësisë për të gjashtë pikat e aktakuzës për

krime kundër njerëzimit.

Krimet kundër njerëzimit kërkojnë prova për një politikë në nivel shtetëror ose organizativ, dhe zakonisht sjellin pasojat më të rënda në aspektin e dënimit në këtë fushë, prandaj rikthimi i disa ose i të gjashtë pikave nuk do të ishte një ndryshim i vogël. Ai do ta rihapte vetë çështjen e dënimit, me gjasë në drejtim të rritjes.

Në aspektin procedural, ai do të garantonte, gjithashtu, një proces më të gjatë: sipas strukturës me tri shkallë të Dhomave të Specializuara, një vendim i Panelit të Apelit që e shndërron një shpallje pafajësie në shpallje fajësie aktivizon një shtresë tjetër shqyrtimi në Panelin e Gjykatës Supreme.

Çfarë ndikimi mund të ketë ky aktgjykim brenda Kosovës, ku UÇK-ja mbetet në qendër të narrativit politik dhe historik të vendit?

Nevenka Tromp: Një nga rezultatet me pasojat më të mëdha të aktgjykimit të Dhomave të Specializuara në çështjen “Thaçi dhe të tjerët” është konstatimi i tyre për ekzistencën e një “ndërmarrjeje të përbashkët kriminale” - një konstatim që bie në kundërshtim të thellë me rezultatet e vetë Tribunalit të Hagës për të njëjtën çështje. Tribunali gjykoj gjashtë komandantë të UÇK-së në dy gjykime për akuza të krahaseshme - keqtrajtimin në kampe ndalimi të njerëzve të

akuzuar për bashkëpunim - dhe të dyja çështjet përfunduan kryesisht me shpallje pafajësie. Në asnjë aktgjykim të Tribunalit të Hagës nuk u konstatua se ekzistonte një “ndërmarrje e përbashkët kriminale” në nivelin e UÇK-së si të tillë - me një qëllim të përbashkët dhe një synim të përbashkët për të kryer krime. Çështjet “Limaj” dhe “Haradinaj” të TPNJ-së, cilido qoftë rezultati i tyre, u zhvilluan gjithmonë mbi një teori të individualizuar: komandantë të identifikuar me emër, që përgjigjeshin për kampe të caktuara ose incidente të caktuara, pa ndonjë konstatim se udhëheqja e UÇK-së, si tërësi, kishte drejtuar një ndërmarrje kriminale. Aktgjykimi i Dhomave të Specializuara bën diçka kategorikisht të ndryshme. Përtej katër të pandehurve të shpallur fajtorë, ai emërton shtatë individë të tjerë - Lahi Brahimajn, Fatmir Limajn, Sylejman Selimin, Rustem Mustafën, Latif Gashin, Shukri Bujën dhe Sabit Gecin - si persona që kishin “ndarë dhe ishin pajtuar me qëllimin e përbashkët kriminal” dhe si vetë “anëtarë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale të pretenduar”, pa qenë asnjëri prej tyre i pandehur në këtë çështje, ose pa pasur mundësinë ta kundërshtonte atë cilësim, siç do të mund ta bënte një i pandehur. Doktrina thotë se konstatime të tilla nuk përbëjnë shpallje formale fajësie për personin e përmendur; ato ekzistojnë vetëm për të përcaktuar formën e përgjegjësisë së të akuzuarve faktikë. Katër të pandehurit ndaj të cilëve u ngrit aktakuzë kaluan nëpër një gjykim kontradiktor. Shtatë të tjerët jo: ata nuk kishin avokatë në këtë procedurë, as mundësi për t'i kundërshtuar provat e përdorura për t'i vendosur emrat e tyre në një aktgjykim publik, dhe as të drejtë apeli, sepse nuk kishin qenë asnjëherë palë që në fillim.

Rasti i Fatmir Limajt e shndërron këtë në diçka më serioze sesa versionin e zakonshëm të problemit. Ai nuk ishte thjesht i paakuzuar dhe i padëgjuar në këtë procedurë. Ai u akuzua nga TPNJ-ja, doli në gjyq, dhe u shpall i pafajshëm në vitin 2005 për, në thelb, të njëjtën kategori akuzash. Ta emërtosh tani, në aktgjykimin e një tribunali tjetër, që ka të bëjë me një pjesë të madhe të së njëjtës sjellje në themel të çështjes, si pjesëmarrës në një “ndërmarrje të përbashkët kriminale”, pa një aktakuzë të re dhe pa një gjykim të ri, në të cilin ai të mund ta kundërshtonte atë cilësim, do të thotë të rihapësh një çështje që një gjykatë tashmë e kishte zgjidhur në favor të tij - jo përmes ndonjë procesi që i jep atij cilësi procedurale për t'u përgjigjur, por përmes një konstatimi të bërë në çështjen e dikujt tjetër.

Dhomat e Specializuara u krijuan nga vetë Kosova, megjithatë aktgjykimi po refuzohet nga shumë figura politike dhe qytetarë. Çfarë do të thotë ky moment për besueshmërinë e Gjykatës, dhe për besimin e publikut në drejtësinë ndërkombëtare në Kosovë?
Nevenka Tromp: Klasa politike që

e refuzon këtë aktgjykim sot mbivendoset në masë të konsiderueshme me atë se e pranoi pa dëshirë krijimin e Gjykatës në vitin 2015, nën trynë të konsiderueshme ndërkombëtare. Kjo mbivendosje vepron në të dyja drejtimet. Do të thotë se kritikët e saj nuk mund ta hedhin poshtë Gjykatën si një imponim tërësisht të huaj, pa asnjë gjurmë vendore, por gjithashtu do të thotë se e njëjta udhëheqje që tani po i kërkon publikut ta shohë aktgjykimin si jolegitim, dikur e vlerësoi krijimin e Gjykatës si diçka që mund të përballohej, madje si të nevojshme, për pozitën ndërkombëtare të shtetit. Kjo dykuptimësi ka të ngjarë ta thellojë, jo ta zgjidhë, gërryerjen e besimit publik tashmë të dukshëm në Kosovë: një gjykatë e krijuar brenda vendit, aktgjykimi kryesor i së cilës kundër udhëheqjes themeluese të vendit refuzohet nga një pjesë e madhe e klasës politike dhe publikut, e minon teorinë se ky ka qenë ndonjëherë një akt plotësisht legjitim i vetëqeverisjes dhe e përforcon një narrativ, tashmë të pranishëm në mbarë rajonin, se gjykata të tilla funksionojnë si instrumente të kushtëzimit të jashtëm dhe jo të llogaridhënies së brendshme.

A ekziston një mënyrë ligjore për ta “zhbërë” Gjykatën?

Nevenka Tromp: Vetë aktgjykimi i shkallës së parë ia njeht Thaçit kontributin e tij për ta bërë të mundur krijimin e Dhomave të Specializuara - pothuajse duke e përqeshur për atë bashkëpunim, tani që ai ka ndihmuar në shpalljen e tij fajtor. Ekziston një parim i përgjithshëm që vlen të përmendet këtu: cilido proces institucional që ka fuqinë për të krijuar diçka, zakonisht ka edhe fuqinë për ta zhbërë atë. I zbatuar te Dhomat e Specializuara, ky mund të ishte, në parim, drejtimi. Por, vetëm nëse Kosova do të ishte në gjendje të çlirohej nga trysnia ndërkombëtare që e prodhoi Gjykatën që në fillim. Në vitin 2017, Kuvendi i Kosovës tentoi vërtet ta shfuqizonte plotësisht ligjin që mundësoi krijimin e saj, dhe tentativa dështoi nën trysinë e vazhdueshme diplomatike të Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Evropian, të cilët e bënë të qartë se zhbërja e Gjykatës do ta rrezikonte liberalizimin e vizave për Kosovën dhe rrugën e saj më të gjerë drejt anëtarësimit në BE. Tani, pas aktgjykimeve konkrete, kjo ka të ngjarë të jetë edhe më e vështirë sesa ishte në vitin 2017, kur ende nuk kishte aktakuza, gjykime ose shpallje fajësie. Ligjrisht mbetet e mundur, por është një ndërmarrje vërtet komplekse: themelimi i Dhomave të Specializuara është sanksionuar drejtpërdrejt në Kushtetutën e Kosovës përmes amendamentit të vitit 2015 që shtoi nenin 162, prandaj shpërbërja e tyre do të kërkonte një amendament tjetër kushtetues, që do të kërkonte një shumicë prej dy të tretash të të gjithë deputetëve dhe një shumicë të veçantë prej dy të



tretash mes deputetëve që mbajnë vende të rezervuara për komunitetet joshumicë - një prag qëllimisht i lartë, i hartuar për ta bërë të vështirë pikërisht këtë lloj kthimi prapa.

Duke parë përtej Kosovës, si mund të ndikojë ky aktgjykim në mënyrën se si diskutohen luftërat e viteve '90, përgjegjësia për krimet dhe drejtësia ndërkombëtare në mbarë Ballkanin Perëndimor?

Nevenka Tromp: Aktgjykimi ndikon drejtpërdrejt në rrefimin themeltar të luftës çlirimtare të Kosovës dhe të shtetësisë së saj. Të dyja mbështeten në masë të madhe të UÇK-ja si forca qendrore çlirimtare. Publiku i Kosovës dhe udhëheqja e saj politike dhe shtetërore ndihen të tradhtuar. Kosova bashkëpunoi me bashkësinë ndërkombëtare që nga vera e vitit 1998, dhe që atëherë ka qenë një partnere dhe aleate e besueshme. Në periudhën e pasluftës, Kosova pranoi një qeverisje të gjerë ndërkombëtare dhe mbeti një aleate besnike gjatë gjithë kohës. Njëzet e shtatë vjet pas humbjes së Kosovës, Serbia është kthyer në lojë, përmes një procesi që përshkruhet më së miri si “lawfare” (luftë me mjete juridike): vazhdimi i objektivave të kohës së luftës me mjete ligjore, duke përdorur të njëjtat gjykata dhe instrumente të drejtësisë penale ndërkombëtare që Beogradi dikur i refuzonte si antiserbe, tani të ripërdorura për ta riformuluar rolin e vetë Serbisë në dhunë dhe për t'i relativizuar aktgjykimet e TPNJ-së kundër zyrtarëve të saj të dënuar, duke e ridrejtuar vëmendjen te “kriminaliteti” i ish-kundërshtarit të saj. Çështja e TPNJ-së për Kosovën, “Shainoviq dhe të tjerët”, prodhoi

dënime përfundimtare, të konfirmuara në apel, prej 22 vjetësh burgim për Nebojsa Pavkoviqin, 18 vjetësh për Nikolla Shainoviqin, 20 vjetësh për Sreten Lukiqin dhe 14 vjetësh për Vlladimir Llazarevqiin - për një ndërmarrje të përbashkët kriminale që tribunali e gjeti përgjegjëse për zhvendosjen me forcë të qindra mijëra shqiptarëve të Kosovës dhe vrasjen e qindra të tjerëve në trembëdhjetë komuna. Millan Millutinoviq, president i Serbisë në atë kohë, u shpall plotësisht i pafajshëm. Dhomat e Specializuara, duke gjykuar një “ndërmarrje të përbashkët kriminale”, të ndërtuar rreth 96 vrasjeve dhe ndalimit të më pak se 400 personave, tani i kanë dënuar dy figurat e saj më të larta me nga 25 vjet burgim - një shifër më e lartë sesa ajo që mori përfundimisht cilido zyrtar serb për një fushatë të një shkalle kategorikisht më të madhe. Në Beograd, aktgjykimi po pritet me diçka të afërt me mosbesimin, edhe mes atyre që mund ta kishin pritë - dhe presidenti Aleksandar Vuçiq do ta përdorë atë sidoqoftë, duke e paraqitur udhëheqjen e UÇK-së gjatë luftës, jo atë të Serbisë, si palën e dënuar më rëndë për krime lufte. Në Prishtinë, efekti shkon në drejtimin tjetër: zhgënjim, me protesta në rrugë që rrezikojnë vazhdimin e paqëndrueshmërisë në shtetin më të ri të Evropës. Kryetari i trupit gjykues e trajtoi këtë drejtpërdrejt gjatë leximit të aktgjykimit, duke theksuar se procedurat “nuk ishin një gjykim mbi legjitimitetin e UÇK-së ose përpjekjen e Kosovës për pavarësi”, dhe, në të njëjtën frymë, se çështja “nuk përcaktoi përgjegjësinë për krimet e

përmasave të gjera të kryera kundër shqiptarëve të Kosovës nga forcat serbe dhe njësitë paramilitare”. Vlen gjithashtu të pyetet pse një gjyqtar e ndien fare nevojën ta udhëzojë publikun se si duhet ta pranojë kuptimin politik të një aktgjykimi. Legjitimiteti, pavarësia dhe fajësia organizative nuk janë kategori juridike për të cilat vendos një aktgjykim, dhe një gjykatë që ndihet e detyruar të menaxhojë mënyrën se si do të interpretohet vendimi i saj, po pranon në mënyrë të nënkuptuar se pritja e atij vendimi nuk mund t'i besohet vetëm arsyetimit juridik. Pasojat nuk kufizohen në Kosovë ose në Ballkanin Perëndimor. Drejtësia penale ndërkombëtare, si institucion, tashmë përballlet me sulme të vazhdueshme retorike nga udhëheqës që janë subjekt i mekanizmave të saj gjetkë. Një çështje me vëmendje të madhe publike, në të cilën një tribunal i mbështetur nga Perëndimi, dhe i financuar nga BE-ja, prodhon një rezultat që një pjesë e konsiderueshme e opinionit të informuar e konsideron joproporcional, politikisht të leverdishëm ose strategjikisht të përshtatshëm për një aktor rajonal në raport me një tjetër, ofron pikërisht atë lloj shembulli mbi të cilin mbështeten argumente të tilla, pavarësisht bazës doktrinare të aktgjykimit individual. Ajo që vihet në lojë nga mënyra se si pranohet ky aktgjykim nuk është vetëm marrëdhënia e Kosovës me aleatët e saj, ose politika e brendshme e Serbisë, por besueshmëria më e gjerë dhe e ardhmja e të gjithë sistemit ndërkombëtar të përcaktimit të përgjegjësisë.

CLARK: DHAMË DËSHMI QË DO TA RRËZOJNË KËTË DËNIM, SHBA TË PUNOJË QË APELI TA MARRË VENDIMIN E DUHUR

PRISHTINË, 17 SHTATOR - Gjenerali i pensionuar amerikan Wesley Clark, i cili e udhëhoqi fushatën ajrore të NATO-s kundër caqeve ushtarake serbe në vitin 1999 për t'i dhënë fund luftës në Kosovë, nuk e kupton arsyeshmërinë e vendimit të Gjykatës Speciale në Hagë dje për t'i dënuar ish-krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës me 81 vjet burgim.

Clark tha se dëshmia e tij dhe dëshmitë e të tjerëve do të shpijnë te rrëzimi i këtij vendimi në Apel. "Por e di që unë dhe shumë të tjerë kemi dhënë dëshmi që do të shpijnë te rrëzimi i këtij vendimi", tha ai në emisionin "Off the Record me Andrea Dangllin" në A2 CNN.

Amerikani tha se nuk i di motivet dhe "çfarë ka ndodhur pas dyerve me gjykatësit" për ta sjellë këtë vendim, të cilin e quan të pakuptimtë. "Sepse duhet parë edhe nga vetë Gjykata e Apelit, por nuk i di motivet dhe çfarë ka ndodhur veçanërisht pas dyerve me gjykatësit. Për mua nuk ka

kuptim, por ndoshta është diçka që ata dinë që ne nuk e dimë", tha ai.

Akuzat mbi të cilat u dënuar ish-drejtuësit e UÇK-së, Clark i quan qesharake dhe të pambështetura në dëshmi të forta. "E kam shumë të vështirë të kuptoj se si mundet një gjykatë e tillë ta dënojë një organizatë të tillë me akuza qesharake që janë bërë dhe që nuk u gjetën dëshmi të forta për to", tha ai. "Dhe në pikëpamjen time, pavarësisht se s'jam jurist, shpresojmë që të kemi një rezultat tjetër në Apel", tha Clark.

I pyetur nëse mendon se ShBA-ja do ta mbështesë pa rezerva këtë proces nëse edhe Apeli konfirmon vendimin e djeshëm, Clark tha se "ShBA-ja dhe vendet e tjera duhet të punojnë për procesin e Apelit që Apeli të dalë me vendimin e duhur".

Clark tha se "mund ta dërgonim edhe George Washingtonin në një gjykatë të tillë". "Nuk ka kuptim të ndëshkohen këta njerëz", tha ai.



KUVENDI I SHQIPËRISË DEL ME DEKLARATË TË PËRBASHKËT PËR UÇK-NË: NUK MUND TË BARAZOHET AGRESORI ME VIKTIMËN

TIRANË, 17 SHTATOR - Kuvendi i Shqipërisë ka dalë me një deklaratë të përbashkët pas vendimit të djeshëm të gjykatës së Hagës ndaj ish-krerëve të UÇK-së, të cilët u dënuar me 81 vjet burg total. Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, Niko Peleshi, ka theksuar se një aktgjykim nuk mund ta rishkruajë historinë e një populli dhe as ta barazojë agresorin me viktimën.

Deklarata e Kuvendit të Shqipërisë:

Kuvendi i Shqipërisë shpreh indinjtatën e thellë dhe mosdakordësinë e plotë me një vendim që e konsideron thellësisht të padrejtë ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

Kuvendi i Shqipërisë rithekson një të vërtetë historike që nuk mund të relativizohet: lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ishte luftë për lirinë dhe çlirimin e Kosovës. Ishte lufta e një populli për t'i dhënë fund represionit, dhunës dhe përndjekjes dhe për të fituar të drejtën për të jetuar të lirë në vendin e vet. Ajo lindi si përgjigje ndaj represionit sistematik, dhunës, spastrimit etnik dhe genocidit të kryer nga regjimi i Slobodan Milosheviçit. Pa luftën dhe sakrificën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kundër pushtimit gjakatar serb, historia

e çlirimit të Kosovës nuk mund të kuptohet. UÇK-ja ishte forcë vendimtare e rezistencës së popullit të Kosovës dhe e rrugës që çoi drejt çlirimit, lirisë dhe pavarësisë së saj. Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi janë të pandashëm nga kjo histori, nga lufta për çlirim dhe nga rrugëtimi i Kosovës drejt lirisë, pavarësisë dhe shtetësisë së saj. Një aktgjykim nuk mund të rishkruajë historinë e një populli. Nuk mund të zhbëjë karakterin çlirimtar të luftës së Kosovës apo të barazojë agresorin me viktimën. Nuk mund të zhbëjë sakrificën e UÇK-së.

Kuvendi shpreh shqetësimin e thellë për standardet e dyfishta në trajtimin e së kaluarës së përgjakshme të rajonit. Nderimet publike dhe shtetërore që u rezervohen personave të dënuar për krime lufte, si edhe glorifikimi i figurave të lidhura me gjenocidin dhe spastrimin etnik, përfshirë Ratko Mladiçin, cenojnë kujtesën e viktimave, pengojnë pajtimin dhe bien ndesh me vlerat europiane.

Kuvendi qëndron kundër çdo përpjekjeje të Serbisë dhe Rusisë për ta instrumentalizuar politikisht këtë proces, për të relativizuar krimet e regjimit të Miloševićit dhe për të delegitimuar luftën çlirimtare, pavarësinë dhe shtetësinë e Kosovës.

Kuvendi i Shqipërisë qëndron në solidaritet të plotë me Kosovën,



popullin dhe institucionet e saj, si dhe pranë Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit dhe familjeve të tyre.

Ë palëkundur mbetet bindja jonë në pafajësinë e tyre dhe po aq e palëkundur mbetet e vërteta historike: UÇK-ja luftoi për lirinë dhe çlirimin e Kosovës.

Ky aktgjykim nuk është fjala e fundit. Kuvendi pret që të gjitha mjetet juridike dhe shkallët e

mëtejshme të procesit të ndiqen deri në fund, duke garantuar respektimin e plotë të standardeve të procesit të rregullt ligjor.

Kuvendi i Shqipërisë angazhohet që: Në të gjitha forumet ndërkombëtare të denoncojë krimet e regjimit serb të Slobodan Milosheviçit në Kosovë, përfshirë aktet gjenocidale, krimet e luftës dhe dhunën seksuale gjatë luftës; të kërkojë drejtësi për viktimat

dhe të dënojë mungesën e angazhimit të autoriteteve serbe për zbardhjen e këtyre krimeve, vendosjen e përgjegjësisë dhe garantimin e drejtësisë për viktimat.

Të koordinojë veprimet me Kuvendin e Kosovës, dhe i bën thirrje të dyja Qeverive tona që gjithashtu të koordinojnë veprimet, me qëllim korrigjimin e kësaj padrejtësie në rrugë institucionale.

Jagxhiu në Kroaci: Kosova synon avancimin e ekosistemit digjital shëndetësor

PRISHTINË, 17 SHTATOR - Ministri i Digjitalizimit dhe Administratës Publike, Lulëzon Jagxhiu, ka zhvilluar takime me institucionet kryesore të Kroacisë përgjegjëse për digjitalizimin e shëndetësisë, në kuadër të qëndrimit të tij zyrtar në këtë shtet.

Jagxhiu ka bërë me dije se takimet me përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Fondit Kroat të Sigurimit Shëndetësor (HZZO) u zhvilluan në kontekstin e

implementimit të projektit KOMPAS, të financuar nga Banka Botërore. Sipas tij, përmes këtij projekti, Ministria e Shëndetësisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Digjitalizimit dhe Administratës Publike, është duke ndërtuar shtyllat kryesore të ekosistemit të informacionit shëndetësor në Kosovë.

Gjatë takimeve është diskutuar përvoja e Kroacisë në zhvillimin dhe funksionimin e shërbimeve digjitale shëndetësore, përfshirë

e-reçetat, e-referimet, regjistrat elektronikë shëndetësorë dhe platformat kombëtare të informacionit shëndetësor.

Po ashtu, temë e diskutimeve ka qenë interoperabiliteti i sistemeve, përdorimi i identitetit elektronik dhe shkëmbimi ndërkufitar i të dhënave shëndetësore.

Me drejtuesit e HZZO-së, sipas Jagxhiut, është diskutuar edhe roli i sistemeve digjitale në zbatimin e sistemit të sigurimeve shëndetësore.



Ministri ka vlerësuar se shkëmbimi i përvojave institucionale dhe teknike me Kroacinë është i rëndësishëm

për avancimin e ekosistemit digjital shëndetësor në Kosovë. Ai ka thënë se ky proces synon përmirësimin e shërbimeve shëndetësore për qytetarët, avancimin e menaxhimit, efikasitetit dhe llogaridhënies në institucionet shëndetësore si dhe forcimin e politikëbërjes së bazuar në të dhëna.

Në fund, Jagxhiu ka falënderuar ekipin e Bankës Botërore për facilitimin e bashkëpunimit me ekosistemin e e-shëndetësisë në Kroaci.

MASH NIS STUDIMIN PËR KOMPETENCËN DIGJITALE TË MËSIMDHËNËSVE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

PRISHTINË, 17 SHTATOR - Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH), në partneritet me Fondacionin Evropian për Trajnime (ETF) dhe Drejtorinë e Përgjithshme për Arsim, Rini, Sport dhe Kulturë të Komisionit Evropian (DG EAC), mbajti takimin inaugurues të Studimit mbi Kompetencën Digjitale të Mësimdhënësve në Republikën e Kosovës.

Studimi do të realizohet përmes SELFIE for TEACHERS, instrument shumëgjuhësh online i Komisionit Evropian, i bazuar në Kornizën Evropiane për Kompetencën Digjitale të Edukatorëve (DigCompEdu).

SELFIE for TEACHERS nuk është instrument për vlerësimin e performancës së mësimdhënësve, por instrument për vetëreflektim, zhvillim profesional dhe përmirësim të vazhdueshëm të praktikës mësimore.

Në nivelin qeveritar, Ministria e Arsimit dhe Shkencës u përfaqësua nga zëvendësministri Përparim Kryeziu. Në fjalën e tij të hapjes, zëvendësministri Kryeziu theksoi rëndësinë e zhvillimit të kompetencave digjitale të mësimdhënësve dhe të përdorimit të të dhënave të besueshme për orientimin e politikave arsimore dhe mbështetjen e zhvillimit të tyre profesional.

Zëvendësministri Kryeziu vlerësoi se ky bashkëpunim përfaqëson një shembull konkret të orientimit të Republikës së Kosovës drejt



standardeve dhe praktikave evropiane në arsim. Ai theksoi se transformimi digjital i arsimit nuk lidhet vetëm me teknologjinë por, para së gjithash, me fuqizimin e mësimdhënësve, të cilët e bëjnë të mundur zhvillimin e arsimit çdo ditë.

Me fjalë mirëseardhjeje pjesëmarrësve iu drejtuan edhe Deirdre Hodson, zyrtare për politika në Komisionin Evropian, DG EAC, dhe Dr. Olena Bekh, eksperte e lartë për zhvillimin e kapitalit njerëzor dhe udhëheqëse e ekipit në ETF. Studimi synon përfshirjen e një grupi të gjerë dhe përfaqësues

të mësimdhënësve nga arsimit fillor, arsimi i mesëm i ulët dhe arsimi i mesëm i lartë, përfshirë arsimin dhe aftësimin profesional. Përmes procesit të vetëreflektimit do të mblidhen të dhëna për kompetencat digjitale të vetëvlerësuar nga mësimdhënësit, me qëllim të identifikimit të nevojave dhe orientimit të mbështetjes së mëtejshme për zhvillimin e tyre profesional.

Alessandro Brolpito, ekspert i lartë për zhvillimin e kapitalit njerëzor në ETF, paraqiti qëllimin, metodologjinë dhe rëndësinë e studimit. Ai theksoi rolin thelbësor të

mësimdhënësve si bartës të ndryshimit në transformimin digjital të arsimit si dhe nevojën për njohjen më të mirë të kompetencave të tyre digjitale, në mënyrë që mbështetja dhe zhvillimi profesional të orientohen mbi bazën e të dhënave.

Shqipe Bruqi, ushtruese e detyrës së drejtoreshës së Departamentit për Digjitalizimin e Arsimit në MASH, paraqiti ekosistemin digjital në shkolla dhe rolin e SELFIE for TEACHERS. Duke folur për rëndësinë e procesit të vetëreflektimit, Shqipe Bruqi theksoi se ky

proces nuk përfundon vetëm të mësimdhënësi, por krijon një ndërlidhje ndërmjet mësimdhënësit, shkollës, komunës dhe ministrisë. Sipas saj, secili nivel ka rol të rëndësishëm në krijimin e një sistemi funksional për mbështetjen dhe zhvillimin profesional të mësimdhënësve. Prof. dr. Krenare Pireva Nuçi nga Universiteti i Prishtinës paraqiti zhvillimet e reja në fushën e pedagogjisë digjitale në Republikën e Kosovës, përfshirë programin e ri EdTech në kuadër të Fakultetit të Edukimit të Universitetit të Prishtinës.

IKShPK: Mbi 95 % e rasteve me fruth janë te personat e pavaksinuar

PRISHTINË, 17 SHTATOR - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka bërë thirrje për vaksinimin e fëmijëve kundër fruthit, duke e cilësuar vaksinimin si masën më të rëndësishme për mbrojtjen e shëndetit të fëmijëve dhe komunitetit. Sipas të dhënave të IKShPK-së, gjatë periudhës 16

prill - 13 shtator 2026 janë konfirmuar gjithsej 164 raste me fruth. Vetëm gjatë javës së fundit janë regjistruar gjashtë raste të reja.

IKShPK ka bërë me dije se mbi 95 për qind e rasteve të konfirmuara me fruth janë te persona të pavaksinuar me vaksinën MMR, e cila mbron nga fruthi, shtyat

dhe rubeola.

Instituti ka njoftuar se, krahas vaksinimit të rregullt sipas kalendarit të vaksinimit, është shtuar edhe vaksinimi i vonuar, i njohur si "catch-up", për fëmijët që për arsye të ndryshme nuk janë vaksinuar në kohën e paraparë.

Gjatë këtij viti, mbi 2 mijë e 794

fëmijë të grupmoshës 2-5 vjeç janë vaksinuar përmes programit "catch-up".

IKShPK ka vlerësuar angazhimin e prindërve, profesionistëve shëndetësorë, institucioneve dhe qytetarëve për rritjen e përfshirjes në vaksinim dhe mbrojtjen e fëmijëve nga fruthi. "Çdo fëmijë i vaksinuar është një



fëmijë më shumë i mbrojtur dhe një hap më afër ndërprerjes së përhapjes së sëmundjes", thuhet në njoftimin e IKShPK-së.

‘PRISHTINA 2026’ PROMOVON PRODUKTET VENDORE DHE HAP MUNDËSI TË REJA PËR BIZNESET

PRISHTINË, 17 SHTATOR - Panairi i Përgjithshëm Ndërkombëtar “Prishtina 2026” po shërben si një hapësirë e rëndësishme për promovimin e produkteve vendore, krijimin e partneriteteve të reja dhe zgjerimin e mundësive për bizneset e Kosovës në tregjet ndërkombëtare. Në këtë panair po paraqiten produkte dhe shërbime nga Kosova, Shqipëria dhe vende të tjera mike, ndërsa pjesëmarrësit e shohin atë edhe si mundësi për krijimin e bashkëpunimeve të reja biznesore. Në hapjen e panairit mori pjesë edhe ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Mimoza Kusari-Lila. Ajo tha se “Prishtina 2026”, përveç promovimit të produkteve dhe shërbimeve, krijon mundësi për partneritete të reja dhe plasimin e produkteve vendore në tregje të reja. “Këtu sot, krahas prezantimit të produkteve dhe shërbimeve, krijohen edhe mundësi për të gjetur partneritete të reja, për të plasuar produkte dhe për ta treguar vlerën e prodhimit të Republikës së Kosovës. Nga Ministria që drejtoj, gjatë këtij viti, në vitin 2026, kemi ndihmuar mbi 74 kompani vendore për pjesëmarrje në nëntë panaire ndërkombëtare, ndërsa në to janë promovuar mbi 1 mijë e 200 produkte ‘Made in Kosova’.

Ministria gjithashtu po mbështet organizimin e panaireve dhe do të vazhdojë të mbështesë e të bashkëpunojë edhe me odat dhe të gjitha organizatat relevante të biznesit në Kosovë. Për të krijuar më shumë mundësi për bizneset tona, po punojmë gjithashtu edhe me ambasadat e vendeve mike këtu në Kosovë. Gjatë këtij viti kemi pasur forume në Itali, Holandë, Austri dhe Gjermani, ndërsa në muajt në vijim, deri në fund të vitit, presim në Kosovë përfaqësues të bizneseve nga Polonia, Turqia, Gjermania dhe vende të tjera, me të cilat jemi në diskutim për të organizuar dhe finalizuar këto aktivitete”, tha Kusari-Lila. Ministria foli edhe për mundësitë e reja për eksport që, sipas saj, krijohen për bizneset e Kosovës përmes marrëveshjeve ndërkombëtare. Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, tha se “Prishtina 2026” u jep mundësi bizneseve që t’i paraqesin prodhimet e tyre dhe të krijojnë lidhje të reja me partnerë nga tregu vendorë dhe ndërkombëtarë. “Do të kemi mundësinë t’i shohim produktet dhe prodhimet e Kosovës. Na mundëson të shohim se pas çdo produkti ka një investim të madh dhe një dëshirë për të arritur më shumë. Duke pasur parasysh se ekonomia jonë si qëllim primar ka



integrimin e shtetit në BE, pikërisht për këtë shërben edhe panairi: që të gjejnë partnerë, prodhues-konsumatorë, biznes për biznes, por edhe tregu kosovar me tregun evropian, pse jo edhe më larg. Sot do të kemi mundësi t’i shohim të gjitha prodhimet tona, kemi mundësi të shohim se çfarë kemi në plan të zhvillojmë tutje, sepse

ekonomia jonë po rritet dhe një shtet i fortë është vetëm kur e ka një ekonomi të fortë”, tha Rafuna. Në “Prishtina 2026” po marrin pjesë edhe biznese nga Shqipëria. Ambasadori i Shqipërisë në Kosovë, Petrit Malaj, tha se bashkëpunimi ekonomik ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë duhet të shkojë përtej shkëmbimit të mallrave.

Ndërkaq, drejtoresha e Drejtorisë për Bujqësi në komunën e Prishtinës, Jeta Rafuna, tha se panairi paraqet një mundësi të rëndësishme edhe për promovimin e prodhimeve bujqësore vendore. Panairi “Prishtina 2026” do të jetë i hapur për vizitorët për tri ditë radhazi, nga ora 09:00 deri në orën 17:00.

RRITET BRUTO PRODUKTI VENDOR, NDËRTIMTARIA DHE SEKTORI FINANCIAR SHËNOJNË RRITJEN MË TË LARTË

PRISHTINË, 17 SHTATOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar të dhënat për Bruto Produktin Vendor (BPV) për tremujorin e dytë (TM2) të vitit 2026, të paraqitura sipas aktiviteteve ekonomike dhe qasjes së shpenzimeve, me çmime aktuale dhe me çmime të vitit paraprak. Sipas të dhënave të ASK-së, gjatë këtij tremujori është evidentuar rritje në disa aktivitete ekonomike. Rritjen më të lartë ndër aktivitete e paraqitura e kanë shënuar aktivitetet financiare dhe të sigurimit, me 15,67 për qind, ndërsa ndërtimtaria është rritur për 15,35 për qind. Rritje është regjistruar edhe në aktivitetet e tjera ekonomike, përkatësisht: Informacioni dhe



komunikimi: 5,04 %; Aktivitetet shkencore, profesionale dhe teknike, si dhe aktivitetet e shërbimeve administrative dhe

mbështetëse: 3,99 %; Tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i automjeteve dhe motoçikletave, transporti dhe

magazinimi, si dhe aktivitetet e akomodimit dhe shërbimit ushqimor: 3,48 %; Industria përpunuese: 3,48 %; Bujqësia, pyjet dhe peshkimi: 2,65 %; Industria nxjerrëse, energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajër, furnizimi me ujë, si dhe aktivitetet e trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave: 2,60 %; Artet, argëtimi dhe çlodhja, aktivitetet e prodhimit të mallrave të familjeve për përdorim të vet dhe shërbime të tjera: 1,29 %; Administrata publike dhe mbrojtja, sigurimi social i detyrueshëm, arsimi, shëndetësia dhe aktivitetet e punës sociale: 0,83 %; Aktivitetet e pasurive të paluajtshme: 0,81 %. ASK-ja ka publikuar të dhëna

edhe për komponentët e BPV-së sipas metodës së shpenzimeve. Sipas kësaj qasjeje, formimi i brutokapitalit është rritur për 11,91 për qind, ndërsa importi i mallrave dhe shërbimeve ka shënuar rritje prej 9,83-përqindësh. Po ashtu, eksporti i mallrave dhe shërbimeve është rritur për 6,82 për qind, shpenzimet e konsumit final të qeverisë për 7,02 për qind, ndërsa shpenzimet e konsumit final të ekonomive shtëpiake dhe NPISH janë rritur për 4,40 për qind. Të dhënat e publikuara nga ASK paraqesin zhvillimet e BPV-së për tremujorin e dytë të vitit 2026 sipas aktiviteteve ekonomike dhe komponentëve të shpenzimeve.

Ministri Basha cakton Besian Hysajn ushtrues detyre të drejtorit të përgjithshëm të KANS

PRISHTINË, 17 SHTATOR - Besian Hysaj është caktuar ushtrues i detyrës së drejtorit të përgjithshëm të Ofruesit të Shërbimeve të Navigacionit Ajror (KANS). Lajmin e ka bërë me dije ministri i Infrastrukturës dhe Transportit, Dimal Basha, në “Facebook”. Basha ka njoftuar se vendimi është marrë nga Këshilli

Mbikëqyrës i KANS-it, pas përfundimit të mandatit të drejtorit të mëparshëm. Në mbledhje ka marrë pjesë edhe ministri i Financave, Hekuran Murati, ndërsa Basha, sipas tij, e kryeson këtë këshill në përputhje me ligjin. “Me përfundimin e mandatit të drejtorit të përgjithshëm të KANS, së bashku me ministrin e

Financave, z. Hekuran Murati, në cilësinë e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të cilin sipas Ligjit e kryesoj unë, kemi mbajtur mbledhjen dhe kemi vendosur që z. Besian Hysaj të caktohet ushtrues i detyrës së drejtorit të përgjithshëm të Ofruesit të Shërbimeve të Navigacionit Ajror, për një periudhë prej gjashtë muajsh,

me mundësi vazhdimi, deri në përzgjedhjen e drejtorit të ri. Me këtë vendim do të garantohet vazhdimësia e drejtimit dhe funksionimit të rregullt në KANS, pa krijuar vakum institucional në një fushë të tillë me rëndësi të lartë për sigurinë dhe rregullsinë e trafikut ajror në Republikën e Kosovës”, ka shkruar Basha.



KY ÇETBOT I VITEVE 1960 ISHTE PARARËNDËS I IA-së: KRIJUESI I TIJ FILLOI T’I FRIKËSOHEJ!

Çetboti i parë në botë e shqetësoi thellësisht krijuesin e tij

Nga: Kelli Marja
KORDUCKI / History

Në vitin 1966, shkencëtari i kompjuterëve Joseph Weizenbaum ndërtoi një program kompjuterik primitiv, të cilin e quajti ELIZA. Pothuajse menjëherë, u pendua për krijimin e tij. E zhvilluar për të imituar shkëmbime të thjeshta psikoterapeutike, ELIZA papritmas shkaktoi reagime të thella. Përdoruesit u hapën, ndanë hollësi intime për veten dhe e trajtuan programin sikur të ishte njeri. Reagimi ishte aq i fortë, saqë thuhet se edhe sekretarja e Weizenbaumit në Institutin e Teknologjisë të Masaçusetsit (MIT) i kërkoi atij të dilte jashtë, që ajo të mund të fliste privatisht me programin. ELIZA njihet gjerësisht si çetboti i parë në botë dhe një version i saj është ende i qasshëm në internet sot. Krijimi i saj e bëri Weizenbaumin pionier të IA-së [inteligjencës artificiale] dhe të modeleve të përpunimit të gjuhës - programe të krijuara për të analizuar dhe gjeneruar përgjigje duke njohur modelet në tekst.

“Ajo që nuk kisha kuptuar ishte se ekspozime jashtëzakonisht të shkurtra ndaj një programi relativisht të thjeshtë kompjuterik mund të nxisnin mendim të fuqishëm delirant te njerëzit krejt normalë”, kujtonte Weizenbaum në librin e tij të vitit 1976, Fuqia kompjuterike dhe arsyeja njerëzore [Computer Power and Human Reason]. Ky fenomen, i cili u bë i njohur si “efekti ELIZA”, e

shqetësoi thellësisht atë. Deri në vdekjen e tij në vitin 2008, ai ia kushtoi jetën të qenit një nga kritikët më të ashpër dhe më të zëshëm të teknologjisë.

Fuqitë e projeksionit

Çetboti i parë në botë nuk ishte menduar kurrë për t’i shtyrë kufijtë e inteligjencës artificiale. “Weizenbaumi e projektoi ELIZA-n më shumë si një eksperiment psikologjik sesa teknologjik”, shpjegon Brian Merchant, autor i Gjaku në makineri: Zanafilla e rebelimit kundër gjigantëve të teknologjisë [Blood in the Machine: The Origins of the Rebellion Against Big Tech]. “Atij i interesonte mënyra se si njerëzit ndërvepronin me makinat dhe e projektoi ELIZA-n si një mjet për ta hetuar atë marrëdhënie”.

ELIZA funksiononte duke skanuar tekstin e shtypur nga përdoruesi, për fjalë kyçe, dhe duke gjeneruar, në bazë të përputhjes së modeleve, përgjigje që ngjanin me bisedën njerëzore. “Mos asgjë tjetër, ELIZA tregon se sa e lehtë është të krijosh dhe të ruash iluzionin e të kuptuarit”, shkroi Weizenbaum. Ai besonte se, sapo të zbuloheshin mekanizmat e programit, “magjia” do të “shkërmoqej”.

Por, Merchanti thotë se Weizenbaumi ishte “i tmerruar” nga mënyra se si përdoruesit kërkonin afërsi emocionale me botin, sidomos duke pasur parasysh se sa bazike ishte teknologjia. Edhe pasi u thuhej se programi ishte rudimentar, përdoruesit vazhdonin t’i



Një grua duke punuar në një kompjuter (Gjenevë, 1966) RDB/ullstein bild via Getty Images

atribuonin ELIZA-s të kuptuarit, empatinë dhe qëllimin. Reagimi zbuloi një të vërtetë shqetësuese për dinamikën njeri-makinë. “Weizenbaumi e kuptoi se dëshira jonë për të krijuar marrëdhënie, dhe lehtësia me të cilën një program kompjuterik mund të ndërtohej dhe të shitej për ta shfrytëzuar atë dëshirë, do t’i linte njerëzit të cenueshëm ndaj shfrytëzimit masiv nga kushdo që zotëronte dhe operonte sistemet kompjuterike”, thotë Merchant. Luke Fernandez, profesor i asociuar në Shkollën e Informatikës të Universitetit Shtetëror Veber, vë në dukje në mënyrë të ngjashme se Weizenbaumi e shihte “fuqinë e

projeksionit” të njerëzve si një faktor të mundshëm rreziku në marrëdhënien në zhvillim midis njerëzve dhe makinerive. “Weizenbaumi e hidhte poshtë idenë se kishte diçka të pashmangshme në drejtimin ku mund të na çonte teknologjia ose se aftësia për të vepruar qëndronte te vetë teknologjia”, thotë Fernandez. Ai shqetësohej se, nëse njerëzit do t’u jepnin tepër besim makinave, mund ta rrezikonin përgjegjshmërinë tonë ndaj njëri-tjetrit.

Si krijohet kuptimi

Weizenbaumi besonte fuqishëm se gjykimi dhe arsyetimi njerëzor mbartnin një përgjegjësi morale, gjë që formësoi mënyrën se si ai e kuptonte teknologjinë dhe IA-në.

I detyruar të ikte nga Gjermania naziste kur ishte adoleshent i ri, Weizenbaumi pa nga afër se si agjenda gjenocidale e nazistëve ishte ndihmuar nga dhjetëra njerëz të zakonshëm që kthenin kokën nga ana tjetër. Ai gjithashtu e kuptoi ndikimin e fuqishëm të propagandës antisemite të nazistëve, e cila i çnjerëzonte familjet hebreje - si ajo e tija - në shërbim të përpjekjes eugenike të nazistëve për të krijuar një të ashtuquajtur racë të përsosur. Kjo fushatë çnjerëzimi mbolli vetëkënaqësi te publiku i gjerë. Duke pasur parasysh prejardhjen e tij, Weizenbaumi shqetësohej veçanërisht nga gjuha çnjerëzore që përdornin disa nga kolegët e tij kur krahasonin arsyetimin njerëzor me mundësitë e IA-së. Ai u zemërua nga përshkrimi që studiuesi i MIT-it, Marvin Minsky, u bëri qenieve njerëzore

si “makina prej mishi” dhe irritohej nga nënkuptimi i teknologjive kryesorë se robotët e së ardhmes mund të përbënin “një korrigjim dhe përmirësim të natyrës”. Weizenbaumi theksonte se kjo mënyrë të menduari kishte ushqyer disa nga mizoritë më të mëdha në histori.

“Në epokën naziste, hebrenjtë paraqiteshin si parazitë, një metaforë që legjitimoi vrasjen masive”, i tha Weizenbaumi gazetarit gjerman Bernhard Pörksen në vitin 1998. “Sot ... ideja se njeriu është thjesht një makinë për përpunimin e informacionit, që mund të zëvendësohet nga një robot, po fiton përmbajtje dhe fuqi”.

Weizenbaumi paralajmëroi se “fuqia e jashtëzakonshme e një imazhi çnjerëzor të njeriut” mund “të përhapet si virus në shoqëri” dhe se njerëzimi duhet të ruhet me vendosmëri prej tij. Megjithatë Weizenbaumi nuk i shpërfillte kurrë aftësitë e ardhshme të teknologjive si IA-ja, fuqia e mundshme e makinave nuk ishte kurrë shqetësimi i tij kryesor. Përkundrazi, ai druhej se projeksionet e njerëzve mbi këto makina do t’ua pengonin gjykimin më të mirë. Në vitet 1970-2000, ai ishte përkrahës i etikës së teknologjisë, duke i nxitur shkencëtarët të përballeshin me pasojat shoqërore të punës së tyre. Rreziku që ai parashikonte nuk ishte se teknologjitë, si IA-ja, do të evoluonin në përbindësja që shkatërrojnë qytetërimin, por se shoqëria do t’i shihte ato si idhuj të remë. Kërcënimi i vërtetë për njerëzimin vinte nga brenda, besonte ai; teknologjia thjesht ia jepte atij një rrugëdalje. Weizenbaumi u përsëriste miqve të tij: “Nuk jam kritik i IA-së. Jam kritik i shoqërisë”. /Telegrafi/



Joseph Weizenbaum demonstroi ELIZA-n (maj 2005)Alamy Stock Photo

STUDIUESIT: NDRYSHIMET KLIMATIKE ÇUAN NË KATASTROFËN E SHEMBJES SË MALIT NË NEPAL

Shembja e akullnajës dhe shkëmbinjve në Nepal vrau rreth 1 400 persona dhe la mijëra të tjerë të zhdukur. Shkencëtarët janë shprehur se ndryshimet klimatike ndihmuan në krijimin e kushteve që çuan në katastrofë. Fillimisht u mendua se shembja ishte shkaktuar nga një tërmet. Tashmë, shkencëtarët e klimës kanë përcaktuar se një seri komplekse faktorësh çuan në katastrofë, ku ndryshimet klimatike krijuan disa herë kushtet paraprake: temperaturat në rritje tërësisht akullnajën, shkëmbinjve permafrostin dhe shtuan ujin nga shkëmbinj, duke destabilizuar shpatin derisa ai u shemb më 26 gusht. “Kjo nuk ishte një ngjarje e vetme që e shkaktoi”, tha Walter Immerzeel, hidrolog malor në Universitetin e Utrechtit në Holandë. “Shembja ndodhi në një lartësi prej rreth 5 150 metrash dhe kishte disa procese që vepronin së bashku gjatë periudhave kohore prej vitesh deri në dekada, dhe jo vetëm një faktor.” Ishte një kombinim kompleks kushtesh, i përqësuar nga ndryshimet klimatike, që bëri të mundur shembjen e shpatit. Ky është përfundimi i studiuesve të World Weather Attribution, një bashkëpunim ndërkombëtar shkencëtarësh



që analizojnë rolin e ndryshimeve klimatike në ngjarjet ekstreme të motit dhe katastrofat. Rritja e temperaturave, e shkaktuar nga djegia e lëndëve djegëse fosile, ka ndryshuar këtë pjesë të Himalajeve për dekada. Pranë vendit të shembjes, skaji i akullnajës ishte tërhequr vetëm 75 metra ndërmjet viteve 1964 dhe 2000. Por nga viti 2010 deri në vitin 2026, tërheqja u përshpejtua ndjeshëm, me 373 metra të tjera. Kjo hoqi shtresën e akullit që mbështeste murin shkëmbor

mbi të. Edhe permafrosti, ose toka e ngrirë përhershëm brenda shkëmbinjve, kishte nisur të shkrihej. Ky proces ndodhi në lartësi nga 4 500 deri në 5 500 metra, një brez kritik që është më i ndjeshëm ndaj ngrohjes. Ndërsa ai shkrihej, muret e malit bëheshin gjithnjë e më të paqëndrueshme. Në ditët menjëherë përpara shembjes, kushtet ishin ekstreme. Korriku dhe gushti, në tërësi, ishin muajt më të ngrohtë të regjistruar ndonjëherë në këtë zonë, ndërsa ndryshimet

klimatike i shtuan rreth 1,5 gradë Celsius temperaturave të rajonit. Një muaj tetor me reshje dëbore të pazakonta në vitin 2025 ka të ngjarë të ketë luajtur gjithashtu një rol, duke prodhuar më shumë ujë nga shkëmbinj. Studiuesit besojnë gjithashtu se tërmeti i vitit 2015 luajti një rol. Tërmeti me magnitudë 7,8 shkaktoi një ortek të mëparshëm në Langtang Lirung, i cili mund të ketë dobësuar masivin shkëmbor në vitet që pasuan, duke krijuar kushtet për shembjen e shpatit.

Studiuesit u përpoqën gjithashtu të përcaktonin nëse rajoni mund të ishte përgatitur dhe përshtatur ndaj kësaj katastrofe. Ata arritën në përfundimin se ngjarja ishte jashtëzakonisht e vështirë për t'u zbuluar, pasi sistemet e paralajmërimit të hershëm në Nepal janë projektuar për përmbajtje të parashikueshme të shkaktuara nga reshjet, dhe jo për ngjarje të shpejta e të njëpasnjëshme si kjo. Përmbajtja ishte më e shpejtë se sistemet e paralajmërimit të hershëm të Nepalit dhe shkatërroi disa pajisje monitorimi gjatë rrugës. Paralajmërimi i parë masiv përmes SMS-ve u dërgua rreth 38 minuta pas shembjes fillestare, por përmbajtja kishte arritur tashmë në kufi vetëm shtatë minuta pas saj. “Kur ngrohja destabilizon çatinë e botës, asnjë masë lokale përshtatjeje nuk mund t'i mbrojtë plotësisht njerëzit e cenueshëm në rrjedhën e poshtme nga një shkatërrim i kësaj përmase”, tha Friederike Otto, profesore e shkencave klimatike në Imperial College London. “Pa një veprim shumë më të shpejtë për të kaluar drejt emetimeve zero të lëndëve djegëse fosile, në mënyrë të pashmangshme do të shohim më shumë katastrofa të kësaj përmase në vitet që vijnë.”

VON DER LEYEN PREZANTON PLANIN E RI TË SIGURISË: KËSHILL EVROPIAN, PROTOKOLL EMERGJENCE DHE MË SHUMË KAPACITETE USHTARAKE

Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, prezantoi në fjalimin e saj për Gjendjen e Bashkimit disa ide të reja për forcimin e sigurisë së Evropës. Propozimet vijnë në një kohë kur lufta në Ukrainë po ndikon gjithnjë e më shumë në sigurinë e vendeve evropiane dhe kur janë shtuar incidentet e dyshuara të sabotimit dhe shkeljet e hapësirës ajrore nga dronët. Von der Leyen tha se Evropa ka tashmë shumë mjete për t'u mbrojtur, por institucionet dhe mënyra e marrjes së vendimeve nuk janë përshtatur mjaftueshëm me kërcënimet e reja.

Këshilli Evropian i Sigurisë

Një nga propozimet kryesore është krijimi i një Këshilli Evropian të Sigurisë, një format i veçantë i takimeve të liderëve evropianë, ku do të marrin pjesë edhe partnerë të rëndësishëm si Ukraina, Britania e Madhe, Norvegjia dhe Kanadaja. Sipas von der Leyen, ky format do të krijonte një hapësirë të përhershme për diskutimin e çështjeve të sigurisë së kontinentit. Ideja nuk është e re. Presidenti francez Emmanuel Macron e kishte propozuar më herët, ndërsa në vitin 2018 ajo

mori mbështetje edhe nga Franca dhe Gjermania. Megjithatë, ende nuk dihet se kur mund të nisë Këshilli i ri dhe çfarë kompetencash konkrete do të ketë. Gjithashtu, mbetet e paqartë se si do të bashkëpunojë me NATO-n dhe formatet e tjera të bashkëpunimit ushtarak evropian.

Një protokoll për emergjencat e sigurisë

Një tjetër propozim lidhet me kërcënimet hibride, si sabotazhet, sulmet kibernetike dhe incidentet me dronë. Von der Leyen kërkoi krijimin e një Protokollit Evropian të Sigurisë, i cili do t'u mundësonte vendeve anëtare të koordinoheshin më shpejt kur përballen me kërcënime serioze që nuk arrijnë nivelin e një sulmi të armatosur. Ideja është krahasuar me nenin 4 të NATO-s. Ky nen lejon një vend anëtar të kërkojë konsultime urgjente me aleatët kur konsideron se siguria, integriteti territorial apo pavarësia politike e tij është në rrezik. Protokollin i propozuar nga Komisioni do të mbështetej te klauzola e mbrojtjes së ndërsjellë në traktatet e BE-së. Nëse një vend do ta aktivizonte



mekanizmin, shtetet e tjera do të mblidheshin për të koordinuar një përgjigje evropiane dhe për të parandaluar përshkallëzimin e situatës. Por disa ekspertë kanë ngritur pikëpyetje nëse një mekanizëm i ri do të sillte realisht më shumë siguri, pasi NATO dhe BE kanë tashmë procedurë për reagimin ndaj kërcënimeve.

BE kërkon më shumë kapacitete ushtarake

Një tjetër pikë e rëndësishme e planit është rritja e investimeve në të ashtuquajturat kapacitete strategjike. Këtu përfshihen satelitët, avionët e transportit ushtarak, furnizimi me

karburant në ajër dhe kapacitetet e inteligjencës. Këto mjete janë të rëndësishme për funksionimin e forcave ushtarake në terren. Von der Leyen njoftoi krijimin e një Instrumenti Evropian për Kapacitetet Strategjike, i cili synon të mbështesë investimet afatgjata në këto fusha dhe t'i koordinojë ato me NATO-n. BE-ja po përgatitet gjithashtu për mundësinë e një pranie më të vogël ushtarake amerikane në Evropë. Komisioneri Evropian për Mbrojtjen, Andrius Kubilius, ka vlerësuar më herët se zëvendësimi i disa kapaciteteve amerikane mund të kërkojë rreth 500 miliardë euro investime. Megjithatë, ende nuk është e qartë se si do të financohet ky plan dhe si do të

bindë BE-ja vendet anëtare të rrisin investimet e tyre.

Çfarë pritet më tej?

Propozimet e von der Leyen pritët të jenë pjesë e strategjisë së re të sigurisë së BE-së, e cila pritët të paraqitet muajin e ardhshëm. Në qendër të saj do të jetë forcimi i bashkëpunimit mes vendeve evropiane, rritja e kapaciteteve të mbrojtjes dhe koordinimi më i ngushtë me NATO-n. Por, për momentin, shumë detaje mbeten për t'u përcaktuar, përfshirë mënyrën e financimit, kompetencat e mekanizmave të rinj dhe mënyrën se si do të funksionojnë në praktikë.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com





QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82



Beshiktashi merr vendim për Rashicën

STAMBOLL, 17 SHTATOR - Beshiktashi po vazhdon me ristrukturimin e ekipit nën drejtimin e trajnerit Vincenzo Italiano. Klubi ka vendosur të ndahet me Milot Rashicën, ndërsa menaxhmenti po për-

gatitet t'i vlerësojë ofertat për sulmuesin e krahut gjatë afatit kalimtar të janarit. Rashica ka regjistruar vetëm gjashtë ndeshje zyrtare këtë sezon për Beshiktashin, por në asnjërën prej tyre nuk ka

qenë startues, duke regjistruar në total 101 minuta në fushë. Ai do të mbetet te Beshiktashi deri në fund të këtij viti përpara se të largohet drejt një ekipi tjetër. Te Beshiktashi i kanë bërë me

dije Rashicës se në janar mund të largohet, pasi nuk bën pjesë në projektin e klubit. Rashica i është bashkuar skuadrës turke në vitin 2023, ndërsa ka kontratë valide deri në verën e vitit të ardhshëm.



DELLOVA DHE KRASNIQI GRUMBULLOHEN ME KOSOVËN



PRISHTINË, 17 SHTATOR - Mbrojtësi Lumbardh Dellova dhe sulmuesi i krahut, Ermal Krasniqi, do të jenë në mesin e futbollistëve të ftuar te Kosova për ndeshjet e Ligës së Kombeve. Skuadra turke Amedspor ka bërë me dije se dyshja Dellova dhe Krasniqi tashmë kanë marrë ftesat për t'u bashkuar me "Dardanët", të cilët këtë muaj dhe muajin

tjetër do t'i zhvillojnë katër ndeshje. Dellova dhe Krasniqi gjatë afatit kalimtar të verës janë transferuar tek Amedspor, duke u shndërruar në lojtarë kyç të ekipit që po debuton në Superligën e Turqisë. Selektori i Kosovës, Franco Foda, sot (e premte) do ta bëjë publike listën e tij, ndërsa Kosova e nis grumbullimin të

hënën, më 21 shtator. Kosova, në sezonin e ri të Ligës së Kombeve, do të luajë për herë të parë në Ligën B dhe do t'i zhvillojë katër ndeshje, dy ndaj Austrisë dhe nga një me Irlandën e Izraelin. Këto ndeshje do të zhvillohen më 24 dhe 27 shtator si dhe më 1 dhe 4 tetor, ku Kosova dy prej tyre do t'i luajë në shtëpi dhe dy në udhëtim.

HIDHET SHORTI I RAUNDIT TË KATËRT TË CARABAO CUP, LIVERPOOL-CHELSEA SUPERSFIDA E MADHE

LONDËR, 17 SHTATOR - Është hedhur shorti i raundit të katërt të Carabao Cup, me Liverpoolin dhe Chelsean që kanë marrë një nga përballjet më të vështira të kësaj faze. Pas përfundimit të pjesës më të madhe të ndeshjeve të raundit të tretë, klubet kanë mësuar kundërshtarët e tyre të ardhshëm, ndërsa vëmendjen kryesore e merr dueli Liverpool - Chelsea. Ndërkohë, Manchester Unitedi është eliminuar herët nga gara për të dytin sezon radhazi, pas humbjes në "Old Trafford".

Liverpool përballlet me Chelsean

Liverpooli ka siguruar kualifikimin pas fitores 3-1 ndaj Tottenham Hotspurit, por shpërblimi për suksesin është një përballje shumë e vështirë



me Chelsean. Skuadra londineze, e drejtuar nga Xabi Alonso, kishte kaluar në raundin tjetër pas një ndeshjeje spektakolare ndaj Leeds United, të cilën e fitoi 6-3 pasi kishte qenë në disavantazh. Kështu, Alonso do të rikthehet në "Anfield", këtë herë si trajner i Chelseat, për një duel që pritet të jetë një nga më interesantët e raundit të katërt.

Arsenali me short më të favorshëm

Arsenali do të përballlet me Fleetwood Town, skuadrën me renditjen më të ulët që ka mbetur ende në garë. "Topçinjtë" kanë siguruar kualifikimin pas fitores 4-2 ndaj Ipswich Town, në një

takim ku talenti i ri Max Dowman ishte një nga protagonistët kryesorë. Në letër Arsenali hyn si favorit i madh për të avancuar më tej.

Manchester City mund të përballlet me Brighton

Manchester City ende duhet ta zhvillojë ndeshjen e raundit të tretë kundër Norwich Cityt në "Etihad". Nëse skuadra e Cityt siguron kualifikimin, shorti e

çon atë drejt një përballjeje me Brightonin në raundin tjetër. Brighton vjen nga një fitore e madhe ndaj Manchester Unitedit në "Old Trafford" dhe mund të ketë kështu një tjetër udhëtim drejt Manchesterit.

Disa përballje të tjera mes klubeve të Premierë Ligës

Shorti ka sjellë edhe disa duele të tjera mes skuadrave të elitës angleze. Evertoni është shortuar kundër Newcastle Unitedit, ndërsa Sunderlandi do të përballlet me Brentfordin. Fulhami do të luajë kundër Crystal Palaces, ndërsa Bournemouthi do ta presë Aston Villan. Përballja Liverpool - Chelsea pritet të jetë supersfida e këtij raundi, ndërsa Arsenali ka marrë një short më të favorshëm mes skuadrave të mëdha.

SHORTI I PLOTË I RAUNDIT TË KATËRT TË CARABAO CUP

Fleetwood Town - Arsenal
Manchester City/Norwich City - Brighton
Everton - Newcastle United
Sunderland - Brentford
Liverpool - Chelsea
Bradford - Peterborough
Fulham - Crystal Palace
Bournemouth - Aston Villa

Nuk ndalet Messi, fiton trofeun e 49 dhe vendos rekord në MLS


MIAMI, 17 SHTATOR - Inter Miami ka triumfuar në "Campeones Cup", pasi ka mposhtur 2-0 skuadrën meksikane Cruz Azul në finalen e kompeticionit. Lionel Messi ka qenë sërish protagonist për skuadrën amerikane, duke zhbllokuar rezultatin në minutën e 24-t. Golin e dytë për Inter Miamin e ka realizuar Casemiro, ish-mesfushori i Real Madridit dhe Manchester Unitedit, i cili ka

vulosur triumfin e skuadrës nga Florida. Për Messin ky ka qenë trofeu i 49 në karrierën e tij të jashtëzakonshme. Argjentinasi numëron 10 tituj të La Ligës, tetë Superkupa të Spanjës, katër Champions League, tri Superkupa të UEFA-s, tri Kupa të Botës për Klube, dy tituj të Ligës 1, dy Kupa të Amerikës, një Kupë Bote, një Finalissima, një medalje olimpike, një Botëror U-20, një

Superkupë të Francës, një League Cup, një MLS Supporters' Shield, një titull të Eastern Conference, një MLS Cup dhe tashmë një "Campeones Cup". Goli ndaj Cruz Azul i ka sjellë Messit edhe një rekord të ri në futbollin amerikan. Ai është bërë lojtari që ka arritur më shpejt kuotën e 100 golave për një klub në historinë e MLS-së, duke llogaritur të gjitha

kompeticionet. Në 114 paraqitje me Inter Miamin, Messi ka realizuar 100 gola dhe ka dhënë 55 asistime. Për tetë herë fituesin e "Topit të Artë", ky ka qenë gjithashtu goli i 36 në një finale, ndërsa numri total i golave të tij në karrierë ka shkuar në 929. Në moshën 39-vjeçare Messi vazhdon të shtojë rekorde dhe trofe në një karrierë që tashmë është pjesë e historisë së futbollit.





N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.
Prishtinë – Kosovë, Luan Haradinaj, p.n.
e-mail..contact@pallatirinise.com
www.pallatirinise.com



Në bazë të dispozitave të nenit 21, pikës 21.4 të Ligjit nr. 03/L- 087 Për Ndërmarrjet Publike, gjegjësisht nenit 13 të Ligjit nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 Për Ndërmarrjet Publike dhe në bazë të nenit 17 të Statutit, Bordi i Drejtorëve i N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A., me datë 11.09.2026 bazuar mbi Vendimin Nr. 1/2058 publikon këtë:

KONKURS PUBLIK
Për plotësimin e një (1) pozite

1. Titulli i punës: Këshilltar/e i/e Përgjithshëm – Sekretar/e Korporativ/e
Vendi: Prishtinë.
Ndërmarrja: N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. me seli në Prishtinë.
I përgjigjet: Bordit të Drejtorëve.
Mandati: 3 vite
Koeficienti: 5.9

2. Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:

Bordi i Drejtorëve, dëshiron të sigurohet që të gjithë kandidatët potencial të jenë persona me integritet të lartë të cilët i plotësojnë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1, (ii) i plotësojnë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2, pikat (d), (f), (j), (k) dhe (l) (iii) nuk janë, ose në çfarëdo kohe gjatë periudhës tridhjetë e gjashtë (36) muajsh para datës së aplikimit nuk kanë qenë Drejtorë të Bordit të kompanisë gjegjëse dhe (iv) kanë përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë; Çdo person i cili dëshiron të merret parasysh për një pozitë të drejtorit duhet që po ashtu t’i përmbushë edhe kushtet e përshtatshmërisë profesionale në vijim:

- Të posedojë diplomë universitare -Fakulteti Juridik (jurist i diplomuar ose master në shkenca juridike);
- Të posedojë së paku pesë (5) vite përvojë profesionale nga fusha e qeverisjes korporative ose të drejtës së shoqërive tregtare;
- Të plotësojë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1 si dhe të plotësojë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2 pikat (d),(f),(j),(k),(l) të Ligjit nr. 03/L -087 të Ndërmarrjeve Publike dhe Plotësim Ndryshimit të LNP nr. 04/L-111 neni 13;
- Aftësi për punë ekipore;
- Të ketë aftësi të mira komunikuese;
- Të ketë etikë në punë dhe integritet.
- Të posedojë njohuri të punës me kompjuter;
- Njohja e gjuhës angleze (e dëshirueshme);
- Dëshmitë mbi njohuritë dhe të arriturat tjera do të mirren në konsideratë dhe vlerësohen konform relevancës me vendin e punës;
- Të jetë person me integritet të lartë dhe të plotësojë të gjitha kushtet e përshtatshmërisë të parapara me neni 17 të Ligjit të Ndërmarrjet publike nr. 03/L-087 , dhe plotësim ndryshimet përkatëse,Ligji për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit public nr/06L-011, si dhe me normat tjera positive relevante.

3. Këshilltar/e i/e Përgjithshëm – Sekretar/e Korporativ/e ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- Sigurohet që të përcillen procedurat e Bordit, ku bëjnë pjesë organizimi i takimeve të Bordit, Komiteteve të Bordit dhe Aksionarëve duke përfshirë (në bashkëpunim me Kryesuesin) përgatitjen dhe shpërndarjen e agjendave;
- Mban regjistrin e aksionarëve;
- Koordinon me KE përgatitjen e materialit për mbledhjet e Bordit të Drejtorëve;
- Mban procesverbalin e mbledhjeve të Bordit të Drejtorëve dhe Komitetit të Auditimit (nëse nuk kërkohet ndryshe nga kryesuesit e tyre) dhe i regjistron në librat e protokolleve;
- Shpërndan procesverbalet tek drejtorët dhe aksionarët;
- Merret me regjistrimin zyrtar të ndryshimeve të cilat kërkohen sipas ligjit, i regjistron në regjistrin e Kosovës për shoqëritë tregtare dhe emrat tregtarë;
- Sipas udhëzimeve nga Kryesuesi, përgjegjësitë e Sekretarit përfshijnë sigurimin e rrjedhjes së mirë të informatave brenda Bordit dhe komiteteve të tij dhe në mes të Bordit dhe menaxherëve të lartë të Ndërmarrjes;
- Këshillat dhe shërbimet e Sekretarit duhet të jenë në dispozicion të të gjithë drejtorëve i cili njëheri është përgjegjës tek Bordi për të siguruar që përputhen procedurat e Bordit;
- Përcjell ndryshimet ligjore që kanë të bëjnë me ndërmarrjen duke informuar Bordin dhe menaxhmentin e kompanisë për ndryshimet si dhe përgatitë udhëzimet e nevojshme për menaxhmentin e kompanisë.Merret edhe me çështjet tjera të qeverisjes korporative sipas nevojës.

4. Informatë për procedurën e konkurimit

- Kandidatët e interesuar për këtë vend pune duhet të bashkangjesin këto dokumente:
- Formulari i kërkesës për punësim (aplikimit);
- Kopje e letërnjoftimit; CV ; Çertifikata e lindjes;Letër motivimi;
- Dëshmitë mbi Shkollimin dhe kualifikimin profesional e noterizuar;
- Diplomat nga universitetet e huaja duhet të jenë të nostrifikuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe e noterizuar.
- Dëshmi për përvojën e punës/vërtetim i lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimeve në atë pozitë;
- Pasqyrat e kontributeve pensionale (nuk kërkohet për përvoja të punës para themelimit të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, dhe për ato përvoja kur punëdhënësit nuk kanë qenë të detyruar të paguajnë në këtë institucion);
- Deklarata nën betim sipas neneve 17.1 dhe 17.2 të Ligjit të NP e cila mundë të shkarkohet nga uebfaqja e Kompanisë;
- Certifikatë nga gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale dhe që nuk është i dënuar për kryerjen e ndonjë vepre penale (jo më e vjetër se 6 (gjashtë) muaj nga data e lëshimit);
- Lista e dokumenteve të dorëzuara.

5. Afati i Konkursit:

Konkursi publik është i hapur në kohëzgjatje prej 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga data 11.09.2026 deri më 10.10.2026

Të interesuarit mund t’i dorëzojnë kërkesat (aplikacionet) e tyre me dokumentet tjera relevante në emailin: burimetnjerezore@pallatirinise.com

Formulari për kërkesë (aplikim) dhe Deklarata nën betim, mund të shkarkohen nga web-faqja e N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. me seli në Prishtinë në <http://www.pallatirinise.com/> ose mund të merren në zyrat e Ndërmarrjes.

6. Vërejtje:

Kandidatët me dokumentacion të pakompletuar, të paplotësuar dhe jo-adekuat dhe jashtë afatit të konkurrimit, do të refuzohen.

Do të kontaktohen vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara dhe përfshihen në listën e ngushtë.

NJOFTIM


Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Altin Emlak Global” SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812321587 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Altin Emlak Global” D.O.O. Pristina donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812321587 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Altin Emlak Global” L.L.C. with headquarters Pristina, has come to the decision to quit its business: 812321587 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.
Prishtinë – Kosovë, Luan Haradinaj, p.n.
e-mail..contact@pallatirinise.com
www.pallatirinise.com

Na osnovu odredbi člana 21, tačke 21.4 Zakona br. 03/L-087 o javnim preduzećima, odnosno člana 13 Zakona br. 04/L-111 o izmenama i dopunama Zakona br. 03/L-087 o javnim preduzećima i na osnovu člana 17 Statuta, Upravni odbor N.P.L. PALATI I RINISE AD, od 11.09.2026. godine, na osnovu Odluke Br. 1/2058 objavljuje ovo:

JAVNI KONKURS

Za popunjavanje jedne (1) pozicije

1. Naziv radnog mesta: Generalni savetnik - Sekretar preduzeća
Lokacija: Priština.

Preduzeće: N.P.L. PALATI I RINISE AD sa sedištem u Prištini.

Odgovoran: Upravnom odboru.

Mandat: 3 godine

Koeficijent: 5.9

2. Generalni savetnik - Sekretar preduzeća ima sledeće dužnosti i odgovornosti: Upravni odbor želi da osigura da svi potencijalni kandidati budu osobe visokog integriteta koje ispunjavaju kvalifikacione uslove iz člana 17.1, (ii) ispunjavaju kriterijume nezavisnosti iz člana 17.2, tačke (d), (f), (j), (k) i (l) (iii) nisu, ili u bilo kom trenutku tokom trideset šest (36) meseci pre datuma podnošenja zahteva nisu bili, direktori Upravnog odbora relevantne kompanije i (iv) imaju neophodno stručno iskustvo i obrazovanje potrebno za predmetnu poziciju; Svako lice koje želi da bude razmatrano za poziciju direktora mora takode ispunjavati sledeće uslove stručne podobnosti:

- Posedovati univerzitetsku diplomu - Pravni fakultet (diplomirani pravnik ili master pravnih nauka);

- Posedovati najmanje pet (5) godina stručnog iskustva u oblasti korporativnog upravljanja ili kompanijskog prava;

- Ispunjavati kvalifikacione uslove iz člana 17.1 i ispunjavati kriterijume nezavisnosti iz člana 17.2, tačke (d), (f), (j), (k), (l) Zakona br. 03/L-087 o javnim preduzećima i izmene ZJP br. 04/L-111, član 13;

- Sposobnost za timski rad;
- Posedovati dobre komunikacijske veštine;
- Posedovati radnu etiku i integritet.
- Posedovati računarske veštine;
- Znanje engleskog jezika (poželjno);
- Dokazi o drugim znanjima i dostignućima biće uzeti u obzir i procenjeni u skladu sa relevantnošću za posao;
- Biti osoba sa visokim integritetom i ispunjavati sve uslove podobnosti utvrđene članom 17 Zakona o javnim preduzećima br. 03/L-087 i relevantnim izmenama, Zakonom o sprečavanju sukoba interesa u vršenju javnih funkcija br. 06/L-011, kao i drugim relevantnim pozitivnim normama.

3. Generalni savetnik – Sekretar kompanije ima sledeće dužnosti i odgovornosti:

- Osigurati da se poštuju procedure Odbora, uključujući organizaciju sastanaka Odbora, odbora Odbora i akcionara, uključujući (u saradnji sa predsednikom) pripremu i distribuciju dnevnog reda;
- Voditi registar akcionara;
- Koordinirati sa Izvršnom komisijom pripremu materijala za sastanke Odbora direktora;
- Voditi zapisnike sa sastanaka Odbora direktora i Odbora za reviziju (osim ako njihovi predsednici ne zahtevaju drugačije) i evidentirati ih u zapisnicima;
- Distribuirati zapisnike direktorima i akcionarima;
- Obavljati zvaničnu registraciju promena koje zahteva zakon, evidentirajući ih u Kosovskom registru trgovačkih društava i trgovačkih imena;
- Prema uputstvima predsednika, odgovornosti Sekretara uključuju obezbeđivanje nesmetanog protoka informacija unutar Odbora i njegovih odbora i između Odbora i višeg menadžmenta Kompanije;
- Saveti i usluge Sekretara biće dostupni svim direktorima i biće odgovoran Odboru za obezbeđivanje usklađenosti sa procedurama Odbora;
- Prati pravne promene koje se odnose na Društvo tako što obaveštava Upravni odbor i rukovodstvo Društva o promenama i priprema neophodna uputstva za rukovodstvo Društva. Takođe se bavi i drugim pitanjima korporativnog upravljanja po potrebi.

4. Informacije o postupku konkursa

- Kandidati zainteresovani za ovaj posao moraju priložiti sledeća dokumenta:
- Obrazac za prijavu za zaposlenje;
- Kopiju lične karte; CV; Izvod iz matične knjige rođenih;
- Motivaciono pismo;
- Overeni dokaz o obrazovanju i stručnoj kvalifikaciji;
- Diplome stranih univerziteta moraju biti overene od strane Ministarstva prosvete, nauke i tehnologije.
- Dokaz o radnom iskustvu/ potvrda izdata od strane nadležne institucije za zapošljavanje o radnom iskustvu, kojom se utvrđuje radno mesto i trajanje angažovanja na tom mestu;

4. Informacije o postupku konkursa

- Kandidati zainteresovani za ovaj posao moraju priložiti sledeća dokumenta:
- Obrazac za prijavu za zaposlenje;
- Kopiju lične karte; CV; Izvod iz matične knjige rođenih;
- Motivaciono pismo;
- Overeni dokaz o obrazovanju i stručnoj kvalifikaciji;
- Diplome stranih univerziteta moraju biti overene od strane Ministarstva prosvete, nauke i tehnologije.
- Dokaz o radnom iskustvu/ potvrda izdata od strane nadležne institucije za zapošljavanje o radnom iskustvu, kojom se utvrđuje radno mesto i trajanje angažovanja na tom mestu;
- Izjave o penzijskim doprinosima (nisu potrebne za radna iskustva pre osnivanja Kosovskog fonda za penzijsku štednju, i za ona iskustva kada poslodavci nisu bili u obavezi da plaćaju ovoj instituciji);
- Izjava pod zakletvom u skladu sa članovima 17.1 i 17.2 Zakona o JP koja se može preuzeti sa veb stranice Kompanije;
- Potvrda nadležnog suda da se ne vodi krivični postupak i da lice nije osuđivano za bilo koje krivično delo (ne starija od 6 (šest) meseci od datuma izdavanja);
- Spisak podnetih dokumenata.

5. Rok za konkurs:

Javni konkurs je otvoren u periodu od 30 (trideset) dana od 11.09.2026 do 10.10.2026. Zainteresovana lica mogu podneti svoje prijave sa ostalom relevantnom dokumentacijom na imejl adresu: burimetnjerezore@pallatirinise.com Obrazac za prijavu i izjava pod zakletvom mogu se preuzeti sa veb stranice N.P.L. PALATI I RINISE AD sa sedištem u Prištini na <http://www.pallatirinise.com/> ili se mogu dobiti u kancelarijama Kompanije.

6. Napomena:

Kandidati sa nepotpunom, nekompletnom i neadekvatnom dokumentacijom i van roka za konkurs biće odbijeni. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju navedene kriterijume i koji su uvršteni u uži izbor.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Pastrim Kimik ALG” SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812209056 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Pastrim Kimik ALG” D.O.O. Pristina donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812209056 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Pastrim Kimik ALG” L.L.C. with headquarters Pristina, has come to the decision to quit its business: 812209056 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

